



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



## NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

### RAPORTI VJETOR 2015



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

## **RAPORTI VJETOR 2015**

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJA</b> .....	<b>9</b>
<b>2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA</b> .....	<b>10</b>
<b>2.1. Historiku i NJIF-K</b> .....	<b>10</b>
<b>2.2. Detyrat</b> .....	<b>11</b>
<b>2.3. Buxheti dhe Prokurimi</b> .....	<b>12</b>
2.3.1. Buxheti.....	12
2.3.2. Aktivitetet e Prokurimit.....	12
<b>2.4. Organizimi i NjIF-K</b> .....	<b>13</b>
2.4.1. Mbikëqyrja e NjIF-K.....	13
2.4.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative.....	13
<b>3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT</b> .....	<b>15</b>
<b>3.1. Zhvillimi i kornizës ligjore</b> .....	<b>15</b>
<b>3.2. Aktet nënligjore</b> .....	<b>16</b>
3.2.1. Udhëzimet Administrative.....	16
3.2.2. Procedurat Standarde të Veprimit.....	16
<b>4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË</b> .....	<b>18</b>
<b>4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare</b> .....	<b>18</b>
4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara.....	18
4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta.....	20
4.1.2.1. <i>Indikatorët e Përgjithshëm dhe specifikë për PPP/PFT</i> .....	23
4.1.2.2. <i>Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta 2011-2015</i> .....	25
4.1.3. Transaksionet e dyshimta për Financim të Terrorizmit.....	29
4.1.4. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG).....	32
4.1.5. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta).....	34
4.1.6. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës).....	35
4.1.7. Ngrirja e transaksioneve bankare.....	36
4.1.8. Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga ndalesat ligjore.....	37
<b>4.2. Analizimi dhe Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet vendore dhe homologët ndërkombëtar</b> .....	<b>38</b>
4.2.1. Analizimi i raporteve të inteligjencës.....	38
4.2.2. Hapja e rasteve me iniciativë të NjIF-K.....	39
4.2.3. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës.....	41
4.2.4. Kërkesat për informata nga institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar.....	43
<b>4.3. Inspektimi i pajtueshmërisë</b> .....	<b>45</b>
<b>4.4. Informatat kthyese</b> .....	<b>46</b>
4.4.1. Informatat kthyese nga Institucionet e zbatimit të ligjit.....	46
<b>4.5. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve</b> .....	<b>47</b>
<b>4.6. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes</b> .....	<b>48</b>
<b>4.7. Publikimi i Raportit Vjetor dhe Tipologjive</b> .....	<b>48</b>
4.7.1. Tipologji.....	49
<b>4.8. Ngritja e kapaciteteve të NjIF-K</b> .....	<b>52</b>
4.8.1. Teknologjia Informative.....	52
4.8.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NjIF-K.....	52
<b>5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....	<b>57</b>

<b>5.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor</b>	<b>57</b>
5.1.1. Bashkëpunimi me Prokurorin e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale	58
5.1.2. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	59
5.1.3. Bashkëpunimi me Doganën dhe Administratën Tatimore	59
5.1.4. Bashkëpunimi me AKI	60
5.1.5. Bashkëpunimi me EULEX	60
5.1.6. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale	61
5.1.7. Memorandumet e Mirëkuptimit	61
<b>5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont</b>	<b>62</b>
5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve	62
5.2.1.1. <i>Kërkesat e Pranuara dhe Shpërndara për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar</i>	63
5.2.1.2. <i>Kërkesat e NjIF-K drejtuar FIU ndërkombëtare për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar</i>	65
5.2.1.3. <i>Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit</i>	66
5.2.1.4. <i>Ndarja Spontane e Informacionit me FIU Ndërkombëtare</i>	66
5.2.2. Bashkëpunimi regjional	67
5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit	68
5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare	69
5.2.4.1. <i>Egmont Grup</i>	69
<b>6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT</b>	<b>70</b>
6.1. <b>Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018</b>	<b>70</b>
<b>7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE</b>	<b>72</b>
7.1. <b>Projektet e financuar nga BE-ja</b>	<b>72</b>
7.2. <b>Projekti i BE&amp;KiE “Kundër Krimin Ekonomik në Kosovë PECK”</b>	<b>75</b>
7.2.1. <i>Cikli i dytë (II) i vlerësimit mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT)</i>	75
7.3. <b>Mbështetja nga Thesari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës</b>	<b>78</b>
7.4. <b>Mbështetja nga OSCE</b>	<b>78</b>
<b>8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017</b>	<b>79</b>

## LISTA E TABELAVE

1. **Tabela 1** *Tabela e ndarjeve dhe realizimit te buxhetit 2015*
2. **Tabela 2** *Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2014-2015*
3. **Tabela 3** *RTD në muaj të pranuar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2015*
4. **Tabela 4** *Indikatorët e PP/FT të paraqitur në RTD*
5. **Tabela 5** *Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2015*
6. **Tabela 6** *Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2015*
7. **Tabela 7** *Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për PP dhe FT te raportuara në NjIF-K 2013-2015*
8. **Tabela 8** *Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për FT te pranuar nga NjIF-K 2013-2015*
9. **Tabela 9** *RTG të raportuara për periudhën 2011-2015*
10. **Tabela 10** *Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve'14-'15*
11. **Tabela 11** *Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme 2011-2015*
12. **Tabela 12** *Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2015*
13. **Tabela 13** *Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit*
14. **Tabela 14** *Kërkesat e OJQ-ve për lirim të njehershëm apo të vazhdueshëm*
15. **Tabela 15** *Rastet e Hapura 2014-2015*
16. **Tabela 16** *Rastet e hapura me iniciative të NjIF-K 2011-2015*
17. **Tabela 17** *Rastet e iniciuara dhe propozuara me iniciative të NjIF-K sipas burimit 2015*
18. **Tabela 18** *Raportet e inteligjencës të shpërndara referuar në institucione përkatëse 2015*
19. **Tabela 19** *Raportet e inteligjencës të shpërndara referuar në institucione përkatëse 2011-2015*
20. **Tabela 20** *Kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K 2011-2015*
21. **Tabela 21** *Kërkesat për informata të shpërndara ose përgjigjur nga NjIF-K 2011-2015*
22. **Tabela 22** *Inspektimi i Pajtueshmërisë 2015*
23. **Tabela 23** *Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014-2015*
24. **Tabela 24** *Trajnimet për subjektet raportuese 2015*
25. **Tabela 25** *Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF-K 2011-2015*
26. **Tabela 26** *MM e nënshkruara me autoritetet vendore*
27. **Tabela 27** *Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2011-2015*
28. **Tabela 28** *Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NjIF-K 2015*
29. **Tabela 29** *Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NjIF-K 2015*
30. **Tabela 30** *Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NjIF-K 2011-2015*
31. **Tabela 31** *Kërkesat e NjIF-K drejtuar FIU tjera homologe 2015*
32. **Tabela 32** *Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K 2013-2015*
33. **Tabela 33** *Memorandumet e Mirëkuptimit me NjIF ndërkombëtare*

## LISTA E GRAFIKËVE

1. **Grafiku 1** *Struktura e stafit të NjIF-K*
2. **Grafiku 2** *Struktura gjinore e të punësuarve në NjIF-K*
3. **Grafiku 3** *Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2015*
4. **Grafiku 4** *Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2014 - 2015*
5. **Grafiku 5** *RTD e pranuar për Pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2015*
6. **Grafiku 6** *RTD të raportuara në vitet 2014 dhe 2015 sipas sektorëve*
7. **Grafiku 7** *Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2015*
8. **Grafiku 8** *RTD të raportuara për Financim të Terrorizmit 2013-2015*
9. **Grafiku 9** *RTG të pranuar sipas formës dhe mënyrës së raportimit 2015*
10. **Grafiku 10** *Numri I RTG-ve të pranuar 2011-2015*
11. **Grafiku 11** *RTG të pranuar 2011-2015*
12. **Grafiku 12** *UTR-të e pranuar 2011-2015*
13. **Grafiku 13** *Rastet e Hapura për analizim 2015*

14. **Grafiku 14** *Rastet e propozuara për t'u hapur me iniciativë të NjIF-K 2011-2015*
15. **Grafiku 15** *Rastet e iniciuara dhe propozuara me initiative të NjIF-K sipas burimit 2015*
16. **Grafiku 16** *Raportet e shpërndara të inteligjencës në vitin 2015*
17. **Grafiku 17** *Raportet e inteligjencës të shpërndara në periudhën 2011-2015*
18. **Grafiku 18** *Kërkesat për informata të pranuar 2015*
19. **Grafiku 19** *Kërkesat për informata të pranuar në NjIF-K 2011-2015*
20. **Grafiku 20** *Kërkesat ndërkombëtare (IRI) drejtuar NjIF-K dhe kërkesat e NjIF-K për NjIF ndërkombëtare (ORI) 2014-2015*
21. **Grafiku 21** *Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të huaja*
22. **Grafiku 22** *Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K 2013-2015*

## LISTA E SHKURTESAVE

NjIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
OJQ	Organizatat Joqeveritare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
PFT	Parandalimi i Financimit të Terrorizmit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
AK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi European
BPCJF	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (brenda PK)
DK	Dogana e Kosovës
DKT	Drejtoria kundër Terrorizmit – (brenda PK)
DRNOJQ	Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
EULEX	Misioni i Bashkimit European për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF/TFVF	Task Forca e Veprimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FT	Financimi i Terrorizmit
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
IMF	Institucion Mikrofinanciar
IPA	Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (i Komisionit Evropian)
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KiE	Këshilli i Evropës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje e mirëkuptimit
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave

NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONK	Oda e Noterëve të Kosovës
PECK	Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë”
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i parave
PSO	Procedura Standarde të Operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NjIF-it)
RKSOKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh)
SHKAÇK	Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës
TI	Teknologjia Informative
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër krimit dhe drogave/United Nations Office on Drugs and Crime
VKR	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale



## 1. HYRJA

Bazuar në nenin 10 të ligjit LIGJI Nr. 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin ligji nr. 04/L-178, NjIF-K publikon raportin vjetor 2015.

Rezultatet për vitin 2015 tregojnë se NjIF-K-ja ka përmbushur dhe tejkaluar indikatorët kyçë të performancës të përcaktuar në Aneksin 1 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018.

Numri i raportimeve për transaksione të dyshimta krahasuar me vitin e kaluar është rritur për 34.92%. Gjithashtu viti 2015 ka rezultuar me një ngritje prej rreth 59 % të numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndara tek autoritetet tjera, duke tejkaluarkështu edhe objektivat e përcaktuara në planin e performancës së NjIF-K.

Viti 2015 ka shënuar përmbylljen me sukses të dy projekteve mbështetëse për NjIF-K, të financuara nga BE.

NjIF-K ka ndërtuar një sistem të TI-së që kryen funksione të përbashkëta për analiza, raportim dhe shpërndarje të dhënave. Gjithashtu NjIF-K ka krijuar sistemet elektronike të shkëmbimit të informatave me shumicën e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe subjektet raportuese. Këto sisteme kanë siguruar një përdorim më efikas të informatave në luftimin dhe parandalimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe veprave penale të ndërlidhura.

Poashtu, NjIF-K ka organizuar trajnime, punëtori me sektorin publik, privat dhe të tretë me qëllim të përmirësimit të parandalimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit dhe për të rritur njohuritë e tyre rreth rolit të NjIF-K.

Personeli në NjIF-K ka kualifikim superior dhe është i trajnuar për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Megjithatë, numri i stafit ka mbetur në shkallë mesatare përkundër zgjerimit të fushëveprimit të përgjegjësive ligjore.

NjIF-K ka të zhvilluar sistemin raportues për subjektet raportuese dhe ka hartuar Procedurat Standarde të Veprimit me qëllim të efikasitetit dhe transparencës më të madhe të funksioneve të NjIF-K. Mbikëqyrjea e pajtueshmërisë për subjektet raportueseka përfshirë shumicën e sektorëve në subjektet raportuese të përfshira në nenin 16 të ligjit për PPP/PFT.

Në vitin 2015, NjIF-K ka iniciuar plotësim ndryshimet e ligjit për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit. Në të njëjtën kohë legjislacioni sekondar dhe udhëzimet administrative janë të hartuara dhe/ose të ndryshuara për të ndihmuar interpretimin dhe implementimin korrekt të legjislacionit.

Anëtarësimi i NjIF-K në organizata ndërkombëtare mbetet një nga synimet kryesore të njësisë, me fokus të veçantë anëtarësimi në Egmont Grup.



## 2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA

### 2.1. Historiku i NJIF-K

Zhvillimet më të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare në fushën e PPP/PFT

<b>Qendra e Inteligjencës Financiare - FIC</b>	<b>Njësia e Inteligjencës Financiare - FIU</b>
<b>Rregullorja 2004/2 dhe themelimi i FIC Kosovë</b>	<b>Ligji 03/L-196 për PPP/PFT</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• 2004 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ka nxjerrë Rregulloren 2004/2, me të cilën ka themeluar Qendrën për Inteligjencë Financiare.</li><li>• 2004 Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale ka hyrë në fuqi më 1 Mars 2004.</li><li>• 2004 Qendra për Inteligjencë Financiare është bërë funksionale në Shtator të vitit 2004 nën menaxhimin e stafit ndërkombëtar të UNMIK-ut.</li><li>• 2005 Rregullorja Nr. 2005/9 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.</li><li>• 2006 Rregullorja Nr. 2006/9 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.</li><li>• 2006 Rregullorja Nr. 2006/53 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• 2010 Ligji Nr. 03/L-196 për PPP/PFT.</li><li>• 2010 Krijimi i NJIF-K si pasardhëse e Qendrës për Inteligjencë Financiare të Kosovës.</li><li>• 2010 Themelimi i Bordit Menaxhues të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës.</li><li>• 2012 Transferimi i kompetencave nga misioni i EULEX tek autoritetet vendore.</li><li>• 2012 Strategjia për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit</li><li>• 2013 Ligji Nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.</li><li>• Aplikimi për anëtarësim në Egmont Grup</li><li>• 2013 Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit</li><li>• 2014 Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018</li><li>• Pjesëmarrja për herë të parë në takimin Plenar të Egmont Grup, Lima Peru</li><li>• 2014 Vlerësimi mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT) – PECK II</li><li>• 2015 Pjesëmarrja në takimin e grupeve punuese të Egmont Grup, Berlin Gjermani.</li></ul>
<b>Bartje e kompetencave nga UNMIK tekEULEX</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>• 2008 Dorëzimi i kompetencave të QIF nga UNMIK-u tek misioni i EULEX-it.</li><li>• 2008 Përdorimi i softuerit goAML.</li></ul>	

## 2.2. Detyrat

NjIF-K është themeluar me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizimit (Ligji PPP/PFT)<sup>1</sup>. Është institucion qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave. NjIF-K është përgjegjëse për kërkimin, pranimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave tek autoritetet kompetente që kanë mandat hetimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mandati dhe kompetencat e NjIF-K si dhe obligimet e subjekteve raportuese dhe përgjegjësitë e tyre janë të definuar në Ligjin për PPP/PFT.



Kompetencat dhe funksionet e NjIF-K janë siç vijon:

1. Kërkimi, marrja, dhe analizimin i aktiviteteve/transaksioneve të dyshimta (RTD), raporteve të parave në të gatshme (RTG) dhe informatave nga burimet tjera në lidhje me dyshim për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
2. Shpërndarjen e informatave në lidhje me dyshimin për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit tek autoritetet kompetente për hetime të mëtutjeshme;
3. Mbikëqyrja dhe inspektimi i subjekteve raportuese për të siguruar pajtueshmërinë me obligimet e raportimit dhe ruajtjes së shënimeve;
4. Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi me FIU homologe në juridiksionet tjera dhe me autoritetet tjera të mbikëqyrjes dhe hetimeve;
5. Trajtime për subjektet raportuese dhe autoritetet tjera të hetuesisë dhe personelit të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
6. Të hartojë statistika dhe raporte dhe më pas ti ofrojë rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë, Doganave të Kosovës dhe/ose personave apo organeve të tjera, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste; dhe
7. Aplikimi i sanksioneve administrative për mos-pajtueshmëri nga subjektet raportuese.

<sup>1</sup>Ligji Nr. 03/L-196 dhe Ligji Nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, 2010 dhe 2013.

## 2.3. Buxheti dhe Prokurimi

### 2.3.1. Buxheti

Bazuar në ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Bordi Menaxhues i Njësisë cakton buxhetin e NjIF-K-së sipas propozimit të Drejtorit të Njësisë. Drejtori në bashkëpunim me Udhëheqësit e departamenteve, dhe zyrtarin për buxhet dhe financa e hartojnë propozimin për buxhetin e NjIF-K. Buxheti përfundimtar përcaktohet në baza vjetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Shënimet e bashkangjitura në vazhdim përfshijnë të dhënat për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 duke përfshirë edhe procesin e rishikimit të buxhetit.

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2015	Buxheti	Buxheti i shpenzuar	%
	ndarja fillestare	pas rishikimit	realizimi	
	1	2	3	4=3/2
Paga dhe mëditje	234,770	189,036	183,398	97%
Mallra dhe shërbime	105,051	105,051	102,972	98%
Shpenzimet komunale	11,475	11,475	9,855	86%
Shpenzime kapitale	0	0	0	0%
<b>Gjithsej</b>	<b>351,296</b>	<b>305,562</b>	<b>296,225</b>	<b>97%</b>

Tabela nr.1 - Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2015

Buxheti fillestar i NjIF-K për vitin 2015 ishte miratuar në vlerë prej 351,296 €, përderisa gjatë procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2015 ka pasur ndryshime në Kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve. Realizimi i buxhetit për vitin në fjalë është bërë në vlerë prej 296,225 € (97%).

### 2.3.2. Aktivitetet e Prokurimit

Viti 2015 ka shënuar zhvillimin e nëntë (9) aktiviteteve të prokurimit, kjo sipas Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Sipas procedurës, aktivitetet e prokurimit janë të ndara në :

1. Një (1) aktivitet i prokurimit ka qenë me procedurë të hapur,
2. Një (1) aktivitet ka qenë kontratat me procedurën të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë,
3. Katër (4) aktivitete kanë qenë me procedurën e kuotimit të çmimeve dhe
4. Tri (3) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale,

Ndërsa sipas vlerës së planifikuar të prokurimit ndarja ka qenë si në vijim:

1. Një (1) është me vlerë të mesme,
2. Pesë (5) janë me vlerë të vogël dhe,
3. Tri (3) janë me vlerë minimale,



## 2.4. Organizimi i NjIF-K

### 2.4.1. Mbikëqyrja e NjIF-K

Bordi menaxhues ("Bordi") i Njesisë për Inteligjencë Financiare themelohet me ligjin për PPP/PFT. Ky bord mbikëqyrë dhe siguron pavarësinë e NjIF-K-së. Ai nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimimi kundrejt NjIF-K-së.

Bordi përbëhet nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili njëherit kryenrolin e Kryetarit të Bordit. Anëtarë të tjerë të bordit do të jenë, ex-officio, Ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Bordi mban takime së paku dy (2) herë në vit.

### 2.4.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe objektivat e NjIF-K kanë qenë të bazuara në Planin e Performancës dhe Resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017, Ligjin për PPP/PFT, Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, akteve nënligjore dhe rregulloreve për zbatimin e këtij Ligji.

Burimet dhe kapacitetet njerëzore të NjIF-K janë orientuar në drejtim të mbështetjes së analizave operacionale dhe mbikëqyrjes së pajtueshmërisë, ku rreth 50% e burimeve e përbën stafi i angazhuar në departamentet në fjalë.


Viti 2015 shënon vitin e parë të mos-prezencës së stafit ndërkombëtar të EULEX në NjIF-K. Nga ky vit, njësia përbëhet vetëm nga stafi lokal. Personeli i EULEX ka dhënë kontribut të frytshëm në njësi duke bartur përvojat dhe njohurit nga vende të ndryshe evropiane dhe më gjerë. Shkuarja e personelit të EULEX ka shkaktuar zvogëlimin e kapaciteteve të NjIF-K, të cilat pritet që në vitet në vijim të plotësohet me staf lokal. Për këtë qëllim NjIF-k ka hartuar dokumentin strategjik të saj "Plani i Performancës dhe Resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017" përmes së cilës planifikohet që njësia të rrisë stafin e tij me gjashtë (6) zyrtarë deri më 31.12.2017. Burimet shtesë do të alokoheshin në funksion të Mbikëqyrjes së Pajtueshmërisë (3), Operacione dhe Analiza (2) dhe Ligjor/Bashkëpunim ndërkombëtar (1).

Në NjIF-K janë të punësuar gjithsej 18 zyrtarë prej të cilëve, strukturën e institucionit e përbëjnë Drejtori i njesisë, tre (3) zyrtarë administrativ dhe katërmbdhjetë (14) zyrtarë profesional. Për të përmirësuar shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin operacional në NjIF-K janë të angazhuar dy (2) zyrtar ndërlidhës nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, një nga Dogana e Kosovës dhe një nga Policia e Kosovës.

Personeli i NjIF-K kanë përgatitje universitare dhe është i kualifikuar dhe i trajnuar, ku 100% e stafit në njësi posedon përgatitje universitare të paktën kualifikimin bachelor kryesisht të diplomuar në ekonomi, juridik, shkenca kompjuterike ose inxhinieri elektrike dhe kompjuterike. Gjinia femërore përfaqësohet me rreth 39 % të punësuarve në NjIF-K.




### Personeli i angazhuar ne NJIF-K 2015




Grafiku nr.1 - Struktura e stafit të Njif-K

### Struktura gjinore



Grafiku Nr.2 - Struktura gjinore e të punësuarve në Njif-K



### 3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

#### 3.1. Zhvillimi i kornizës ligjore

Si vazhdimësi e veprimeve të ndërmarra në vitin 2014, Ministria e Financave kishte nxjerr vendim për themelimin e Grupit punues për hartimin e koncept dokumentit për trajtimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Grupi Punues ka qenë i përbërë nga përfaqësues të institucioneve vendore dhe të përkrahur nga ekspertët ndërkombëtar të projektit të financuara nga BE-ja për “Mbështetjen e Institucioneve të Kosovës për Luftimin e Krimin Ekonomik dhe Financiar”.

Gjatë vitit 2015, ky grup ka mbajtur disa takime punuese dhe kryesisht është fokusuar në identifikimin e nevojës së përbushjes së standardeve ndërkombëtare të rishikuara të TFVF për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në identifikimin nëse ligji në fuqi ka probleme të cilat vështirësojnë implementimin e tij.

Pas analizimit të ligjit në fuqi grupi punues ka arritur në përfundim se ky ligj ka nevojë të ndryshohet me qëllim që të sistematizohet struktura dhe përmbajtja duke ndryshuar dhe përfshirë disa dispozita të reja me qëllim të harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare dhe për të korrigjuar gabimet teknike me qëllim të evitimit të pengesave në zbatim të legjislacionit.

*Për më tepër Raporti i Progresit i BE thekson se “Sa i përket veprave penale të shpëlarjes së parave, korniza ligjore e Kosovës në përgjithësi është në përputhshmëri me Konventat e Vjenës dhe të Palermos. Megjithatë, mbeten disa zbrazëtira për të cilat Kosova duhet të bëjë përpjekje që të harmonizojë legjislacionin dhe praktikën e saj me rekomandimet e TFVT-së.*

Në muajin shkurt të vitit 2015, Qeveria e Kosovës ka miratuar Koncept Dokumentin për ngritjen e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe pas kësaj Ministria e Financave ka themeluar Ekipin përgjegjës për hartimin e draftit fillestar të Projektligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

***Në aspektin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare,*** është konstatuar se ligji është në masën më të madhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF), përkatësisht me 40 Rekomandimet, të cilat janë rishikuar në vitin 2012. Mirëpo, në këtë drejtim janë identifikuar mangësitë e caktuara, e veçanërisht ato përkitazi me parandalimin e financimit të terrorizmit.

***Në aspektin përmbajtësor,*** është konstatuar se ligji përmban disa probleme lidhur me subjektet raportuese, mbikëqyrjen e pajtueshmërisë, sanksionet administrative dhe menaxhimin e rreziqeve të PPP/PFT, të cilët janë konsideruar të nevojshme që të trajtohen.

***Në aspektin strukturor dhe sistematik,*** Ligji 03/L-196 ishte plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L-178 dhe me gjasë këto plotësime ndryshime kanë ndikuar në



*strukturën komplekse të ligjit dhe disa gabime teknike në ligj të cilat kanë ndikuar në implementimin efektiv.*

Ekipi punues ka hartuar ndryshimet ligjore me qëllim që të reflektoj këto mangësi të identifikuar duke bërë si në vijim:

- Sistematizim të strukturës dhe përmbajtjes së ligjit;
- Ndryshim të dispozitave të caktuara;
- Korrigjim të gabimeve teknike; dhe
- Harmonizimin e mëtejshëm të legjislationit me standardet ndërkombëtare të TFVF dhe Direktivën e BE-së Nr. 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ndryshimet e hartuara nga grupi punues janë bërë me qëllim të evitimit të pengesave në zbatimin e legjislationit në fuqi dhe në fund të vitit 2015 janë përcjellë tek Ministria e Financave për procedimit të mëtutjeshëm.

### **3.2. Aktet nënligjore**

#### **3.2.1. Udhëzimet Administrative**

Në pajtim me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i ndryshuar, dhe me qëllim të sigurimit dhe promovimit të pajtueshmërisë me ligjin në fuqi, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës në fillim të vitit 2015 ka nxjerr Urdhëresën Administrative NjIF-K Nr. 02/2015 për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave duke vendosur rregulla, procedura dhe indikatorë për subjektet raportuese me qëllim që të parandaloj përdorimin e shërbimeve, lehtësirave apo resurseve të subjekteve raportuese në Kosovë dhe ofroj përkrahje subjekteve raportuese duke përpiluar listën e indikatorëve për pastrimin e parave.

Po ashtu është nxjerrur Urdhëresa Administrative NjIF-K Nr. 03/2015 për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit që ka për qëllim që të luftojë financimin e terrorizmit si një shtyllë esenciale në luftën kundër terrorizmit, të parandaloj përdorimin e shërbimeve, lehtësirave apo resurseve bankare dhe financiare në Kosovë nga personat dhe entitetet e dyshuara për financim të terrorizmit dhe aktiviteteve terroriste dhe të ofrojë përkrahje për subjektet raportuese duke krijuar listën e indikatorëve të financimit të terrorizmit me qëllim të aplikimit të kujdesit të duhur të shtuar nga subjektet raportuese.


#### **3.2.2. Procedurat Standarde të Veprimit**

Me qëllim të lehtësimit të punës së NjIF-K sa i përket procesit të analizave, punës në goAML, mbajtjes së statistikave dhe ofrimit të ndihmës si dhe lehtësimit të raportimit të subjekteve raportuese në goAML, gjatë këtij vitit NjIF-K ka hartuar procedura standarde të operimit lidhur me çështjet të ndryshme operative si në vijim:





1. Procedura Standarde e Veprimit mbi procesin e punës së NjIF-K për Analiza dhe Inteligjencë (13.01.2015),
2. Procedura Standarde të Veprimit për goAML bazuar në proceset e punës (13.01.2015),
3. Procedura Standarde e Veprimit për Statistikat e NjIF-K (13.01.2015),
4. Manual i përdoruesit për formularët goAML (13.01.2015),
5. Web manualii goAML për përdorues për subjektet raportuese (13.01.2015).



## 4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË


### 4.1. *Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare*

#### 4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara

Statistikat e besueshme janë me rëndësi vitale për NjIF pasi që ato nuk i përshkruajnë vetëm indikatorët kyç të performancës mirëpo edhe faktet rreth mjedisit operativ dhe punës në progres që janë thelbësore për analiza strategjike. Me qëllim të grumbullimit dhe përpunimit të dhënave statistikore, në fillim të vitit 2015 NJIF-K ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Statistikat e NjIF-K. Sistemi i NjIF-it për menaxhim të të dhënave 'goAML', grumbullon të dhëna për qëllime statistikore në mënyrë automatike.

Forma e menaxhimit të raporteve të krijuara në vitin 2014, ka krijuar një bazë të mirë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore. Të gjitha këto raporte mund të integrohen në sistem, qoftë përmes formës dhe mënyrës online të raportimit duke ngarkuar XML raportin në formatin XML, apo përmes formës manuale.

Gjatë vitit 2015, në sistemin elektronik të NjIF-K janë proceduar gjithsej 8,529 raporte. Këto raporte të ngarkuara në sistemin goAML konsistojnë në: Raportet e informacioneve shtesë (AIF), Raportet e transaksioneve në para të gatshme (CTR), Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga raportimi (ER), Raportet për pezullimin e transaksioneve (FRZ), Raportet e Inspektimit të Pajtushmërisë (INR), Kërkesat vendore për Informata të pranuar (IRD), Kërkesat ndërkombëtare për informata të pranuar (IRI), Kërkesat e NjIF-K për autoritetet vendore (ORD), Kërkesat e NjIF-K drejtuar NjIF-ve ndërkombëtare (ORI), Raportet e transaksioneve të dyshimta (STR), Raportet e transaksioneve të dyshimta për financim të terrorizmit (TFR) dhe Raportet e transaksioneve të pazakonshme (UTR).




Grafiku Nr.3 – Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2015

Krahasuar me një vit më parë, ka një rënie të numrit të raporteve për rreth 20%, e cila është ndikuar nga rënia e numrit të Raporteve të informative shtesë si rezultat i ngjarjeve dhe zhvillimeve të ndërmarra në vitet e kaluara. Raportimet gjatë vitit 2015 ishin karakterizuara me një ngritje të lartë të numrit të transaksioneve të dyshimta, e cila ishte ngritja më e lartë që nga themelimi i NjIF-K. Ky vit raportues është karakterizuar edhe me një ngritje të numrit të raporteve të transaksioneve në para të gatshme. Kërkesat për shkëmbim të informacionit me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare janë zvogëluar në vitin 2015 krahasuar me një vit më parë.

Viti	2014	2015	+/-
Lloji I Raportit	Numri i të dhënave dhe raporteve të proceduara		
AIF	6016	3975	-33.93%
BCR	0	6	N/A
CTR	2010	2339	+16.37%
ER	16	15	-6.25%
FRZ	20	6	-70.00%
INR	35	26	-25.71%
IRD	177	110	-37.85%
IRI	19	17	-10.53%
ORD	1992	1616	-18.88%
ORI	25	17	-32.00%
STR (ML)	293	395	+34.81%
TFR	1	3	+200.00%
UTR	3	3	+0.00%
<b>Gjithsej:</b>	<b>10,607</b>	<b>8,528</b>	<b>-19.60%</b>

Tabela Nr.2 – Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2014-2015



Grafiku Nr.4 – Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2014 - 2015

#### 4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta

Siç përcaktohet në Ligjin për PPP/PFT, subjektet raportuese të renditura në nenin 16 kanë detyrimin të raportojnë në NjIF-Kaktet ose transaksionet e dyshimta brenda një periudhe kohore të përcaktuar me ligjin në fuqi, varësisht nga sektori apo subjekti raportues, nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë. Ligji në fjalë përkufizon “*aktin apo transaksionin e dyshimtë*” si një akt ose transaksion, ose një akt ose transaksion i tentuar, që gjeneron një dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit.

Forma dhe përmbajtja e raportit të transaksionit të dyshimtë dhe, rrjedhimisht, mënyra në të cilën duhet të përcillet informacioni përkatës, përcaktohen nga NjIF-K.

NjIF-K gjithnjë i ka kushtuar rëndësi dhe ka pasur prioritet sensibilizimin dhe nxitjen e subjekteve raportuese, sektorit privat dhe institucioneve shtetërore për të identifikuar aktivitete të dyshimta për pastrim parash apo financim të terrorizmit, dhe për t'i raportuar ato tek autoriteti përgjegjës, në këtë rast, NjIF-K.

Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta është rritur dukshëm në vitin 2015 në krahasim me vitet e kaluara. Në këtë vit, NjIF-K ka pranuar gjithsej 398 raporte të aktiviteteve ose transaksioneve të dyshimta të raportuara në bazë të Ligjit për PPP/PFT. Kjo korrespondon me një rritje prej rreth 35% krahasuar me 295 RTD të raportuara në vitin paraprak 2014.

Rezultatet për vitin 2015 tregojnë se NjIF-K-ja ka përmbushur dhe tejkaluar (për rreth 59%) indikatorët kyç të performancës të përcaktuara në Shtojcën 1 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Treguesit kyç të performancës për matjen dhe monitorimin e efikasitetit të kësaj Strategjie ndër të tjera kanë përcaktuar numrin minimal të raporteve të pranuar të transaksioneve të dyshimta (RTD). Këta tregues kanë paraparë që NjIF-K për vitin 2015 të pranojë 250 raporte të transaksioneve të dyshimta, përderisa rezultatet kanë treguar që në këtë vit janë pranuar 398 raporte të tilla. Kjo tregon për një ngrije të theksuar të raportimit të RTD-ve dhe tejkalim të numrit të paraparë në Planin e Veprimit.


Përveç që ishin bërë rritje të numrit dhe cilësisë së RAD, është vlerësuar edhe si progres i arritur në lidhje me masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet raportuese, është bërë zgjerimi i kategorisë së subjekteve që kanë raportuar RAD, si dhe ka vazhduar raportimi i tillë në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit.

Dyshimet për pastrim të parave përbëjnë pjesën më të madhe të raportimit të transaksioneve të dyshimta (93%), përderisa raportimet për financim të terrorizmit përfshijnë rreth 7% të dyshimeve të ngritura gjatë vitit 2015.



Treguesi Kyç   Performancës	Muaji	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Gjithsej RTD 2015	%
Numri i raporteve të marra mbi transaksionet e dyshimta PP (RTD)		30	22	27	22	64	24	28	24	43	35	21	32	372	93%
Numri i raporteve të marra mbi dyshimin e financimit të terrorizmit		3	2	5	1	2	3	0	1	0	5	2	2	26	7%
Gjithsej		33	24	32	23	66	27	28	25	43	40	23	34	398	100%

Tabela Nr.3 -RTD në muaj të pranuar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2015



Grafiku Nr.5 -RTD e pranuar për Pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2015

Dërgimi i informatave kthyesë specifike dhe publikimi i tipologjive, si dhe udhëzimeve të lëshuara për subjektet raportuese, do të çojnë në raportimin e RTD-ve me cilësi gjithnjë e më të mirë.


Rreth 92% e raporteve të dyshimta të pranuar në vitin 2015 janë proceduar për t'u analizuar nga NJIF-K në vitin në shqyrtim, ndërsa pjesa tjetër mbetet të analizohet në vitin pasues.

Si çdo herë sektori financiar përbën pjesën më të madhe të raportimit të transaksioneve të dyshimta (përafërsisht rreth 98%).Sektori bankar mbetet lider në lidhje me raportimin e transaksioneve të dyshimta të cilat përbëjnë edhe përqindjen më të madhe të dërgimit të këtyre raporteve. Në vitin në shqyrtim, sektori bankar ka ngritur numrin e raportimit të RTD-ve nga 234 sa ishte në vitin paraprak në 350 në vitin 2015 (+67%). Ky sektor përfaqëson rreth 88 % të numrit total të raportimit të transaksioneve të dyshimta.

Numri i raporteve të dërguara nga Agjensionet për Transfer të Parave ka pasur rënie në vitin 2015 (-30%), pavarësisht se në dy vitet e fundit krahasuar me vitet e kaluar vërehet një ngritje



e konsiderueshme e numrit të raportimit të transaksioneve të dyshimta nga kjo kategori raportuese.



Grafiku Nr.6- RTD të raportuara në vitet 2014 dhe 2015 sipas sektorëve

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në grafikonin më lartë mund të vërehet se për herë të parë nga themelimi i NjIF-K ka filluar raportimi i aktiviteteve të dyshimta nga ZKK dhe mbikëqyrësit sektorial, e cila krahasuar me vitet e kaluara tregon se është zgjeruar lista e subjekteve raportuese, fakt ky që njëherit reflekton edhe përkushtimin gjithnjë e në rritje të subjekteve raportuese në identifikimin dhe raportimin e rasteve të dyshimta. Kjo është një hap pozitiv i ngritjes së vetëdijes dhe zgjerimit të kategorive të raportimit nga subjektet e ligjit dhe të tjerët. Roli i njesisë në këtë drejtim ka qenë i theksuar si rezultat i angazhimeve dhe impaktit gjatë viteve të fundit në:

- Aktivitetet trajnuese, duke marrë pjesë dhe organizuar trajnime në lidhje me PPP/PFT, me pjesëmarrjen e shumicës së subjekteve raportuese duke pasur fokusin tek zyrtarët e bankave dhe institucioneve financiare, noterët, kontabilistët e certifikuar, auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimor, avokatët, kompanitë e sigurimeve, zyrat kadastrale komunale, kazinotë dhe lojërat e fatit, OJQ-të etj,
- Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit,
- Komunikimin e vazhdueshëm me shoqatën e bankave dhe institucioneve mikrofinanciare, odën e avokatëve, shoqatën e noterëve, shoqatën e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve, etj;
- Promovimine parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë,
- Komunikimin me mbikëqyrësit sektorial dhe autoritetet licencuese në lidhje me ecurinë e zbatimit të masave parandaluese nga ana e subjekteve raportuese,

- Zhvillimin, standardizimin dhe intensifikimin e proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit me subjektet raportuese për zbulimin dhe identifikimin e pastrimit të parësë dhe financimit të terrorizmit dhe veprave tjera të ndërlidhura,
- Intensifikimin e raportimit të RAD-ëve dhe RTG-ve duke implementuar Procedurën Standarde të Veprimt që përmban udhëzimet dhe modelet e raportimit të cilat janë specifike për secilin subjekt raportues,
- Publikimin e Tipologjive dhe dërgimin e informative kthyesë duke hartuar statistika dhe raporte dhe duke dërguar rekomandime në lidhje me vlerësimin e kualitetit të raportimeve,
- Hartimin dhe shpërndarjen e indikatorëve të PP/FT

#### 4.1.2.1. Indikatorët e Përgjithshëm dhe specifikë për PPP/PFT

Indikatorët e pastrimit potencial të parave dhe financimit të terrorizmit të paraqitura me rastin e raportimit të RTD/RAD-ve synojnë ngritjen dhe vetëdijësimin e subjekteve raportuese në pajtim me PPP/LFT, të cilët nuk nënkuptohet se janë të vetmit por ofrojnë shembuj për mënyrat më bazike se si mund të bëhet pastrimi i parave. Në tabelën më poshtë janë paraqitur disa nga ata indikator të identifikuar dhe raportuar si RTD gjatë vitit 2015.

Indikatorët e PP/FT	Nr i indikatorëve në RTD
Aktivitetet ose Transaksione të kryera nën dyshimin e financimit të terrorizmit	8
Aktiviteti i llogarisë është jo-konsistent me profilin e klientit;	40
Aktiviteti i pazakonshëm i parave në të gatshme në llogaritë në bankë të huaj, depozitimet të shumëfishta në shuma të vogla dhe transferimet i tyre në shuma të mëdha në shtetet e huaja.	2
Blerja e asetëve në vlerë të lartë (p.sh. patundshmëri, vetura luksoze);	34
Depozitime të mëdha në para në të gatshme të bëra në llogarinë individuale apo të personit juridik ku normalisht aktiviteti i biznesit të individit apo personit juridik mund të bëhet në metoda tjera të pagesës;	9
Depozitime të rregullta të shumëfishta në para në të gatshme të cilat duket se janë të ndërlidhura dhe nën pragun raportues prej 10,000 Euro të transaksionit të parave në të gatshme;	97
Depozitimet në para në të gatshme në vlera të larta për të paguar transferet ndërkombëtare të fondeve;	2
Depozitimi apo tërheqja e instrumenteve të shumëfishta monetare në shumat të cilat në mënyrë të vazhdueshme janë shumë afër apo nën-pragun identifikues apo raportues;	29
Evazion Fiskal/Kontrabandë	3
Investime të mëdha në patundshmëri duke përdorë kredi të pasuara nga shlyerja e shpejtë dhe e hershme e parave të tërhequra;	4
Klientët e shumëfishtë bëjnë transfere ndërkombëtare të fondeve te përfituesit e njëjtë në vendet "offshore";	13
Klienti pranon transfere të shumëfishta vendore në vlera të larta në llogarinë e tij personale nga llogaria e një kompanie, që pasohet nga transfere dalës ndërkombëtar të fondeve ekuivalente në vlerë me transferet vendore	1

Klienti refuzon të ofrojë informata të kërkuara nga institucioni financiar gjatë hapjes së llogarisë, tenton që të zvogëloj nivelin e informatave të ofruara në minimum apo ofron informata ç'orientuese apo që vështirë verifikohen;	2
Kompanitë apo institucionet financiare të përfshira janë themeluar në vendet të njohura si "parajsat" tatimore apo qendrat "offshore";	3
Llogari biznesi përmes të cilave bëhet numër i madh i transfereve hyrëse dhe dalëse elektronike dhe për të cilat duket se nuk ka ndonjë biznes logjik apo qëllim ekonomik, veçanërisht kur ky aktivitet është në, përmes apo nga vendet të cilat ngritin shqetësimin për PP/FT	2
Lokacionet e shumëfishta gjeografike të cilat shfrytëzohen për të kryer transferet që duket se janë të ndërlidhura;	1
Mashtrim	4
Pagesat përmes llogarive përdoren në mënyrë të vazhdueshme për fondet me origjinë nga jashtë. Këto fonde më pastaj janë transferohen shpejt në llogaritë e kompanive në vendet e njohura si "parajsat" tatimore apo qendrat offshore;	2
Përdorimi i dokumenteve false;	2
Përdorimi i kazinove dhe aktivitetet e lojërave të fatit	1
Përdorimi i llogarive të huaja të anëtarëve të familjes, të emëruarve etj;	2
Përfshirja në transaksione e individëve të cilët janë pjesë e listës së njohur ndërkombëtarisht të individëve dhe organizatave, siç përcaktohet me Urdhëresë Administrative;	3
Përzjerja e depozitave të parave në të gatshme dhe instrumenteve monetare në një llogari në të cilën transaksionet e tilla nuk duken se kanë ndonjë lidhje me përdorimin normal të llogarisë;	2
Profesioni i deklaruar i transferuesit nuk korrespondon me nivelin apo llojin e aktivitetit, për shembull, studenti apo individ i papunë i cili pranon apo dërgon numër të mëdha të transfereve elektronike, apo i cili bën tërheqje të shumëfishta maksimale	1
Qarkullim i lartë në llogarinë që përfshin shuma të konsiderueshme të fondeve në para në të gatshme;	16
Strukturimi i blerjeve të basteve, pagesave dhe tërheqjeve;	1
Strukturimi i fondeve përmes transfereve apo transaksioneve;	9
Tërheqjet në para në të gatshme kryhen në degë të ndryshme bankare dhe/ose ATM, në të njëjtën ditë;	1
Trafikim me qenie njerëzore dhe kontrabandimi i imigrantëve	1
Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë nga lokacione të ndryshme gjeografike;	1
Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë tek i njëjtit përfitues;	2
Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, të kryera në të njëjtën ditë në të njëjtën degë të institucionit financiar por me tentim të dukshëm për të përdorë sportele të ndryshëm;	1
Transaksione të ngjashme të kryera përgjatë një periudhe të shkurtë kohore;	4
Transaksionet dhe kompanitë e përfshira janë nga shtetet apo juridiksionet jo-bashkëpunuese të përcaktuara nga TFVF.	3
Transaksioni nuk është ekonomikisht i arsyeshëm, duke pasur parasysh biznesin dhe profesionin e bartësit të llogarisë;	2
Transaksioni nuk ka ndonjë qëllim racional (të qartë dhe relevant) ekonomik apo biznesor;	4
Transfere ndërkombëtare të fondeve nga llogaria individuale te disa llogari "offshore" të mbajtura nën të njëjtin emër;	1
Transfere të dyshimta për Pastrim të parave	188




Transferet dalëse korrespondojnë të jenë transfere hyrëse të fondeve që duken të jetë transaksion 'kthyes';	3
Transferet e shumëfishta të fondeve ndërkombëtare në vlera të ulëta të cilat duket se janë të ndërlidhura, dhe mundësisht tregojnë shuma të madhe të fondeve të ndara në shuma të vogla (shpërndarje)	1
Transferet e shumëfishta të fondeve në vlera të ulëta të cilat duket se janë të ndërlidhura;	1
Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje dhe bëhen nga i njëjti lokacion	1
Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me përfituesit e përbashkët;	2
Transferet elektronike të urdhëruara në shuma të vogla në përpjekje për t'iu shmangur kërkesave të identifikimit apo raportimit;	1
Transferet elektronike tek apo për individin, kur informatat mbi dërguesin, apo personin në emër të cilit bëhet transaksioni, nuk janë dhënë me transferim elektronik, atëherë kur përfshirja/dhënia e informatave të tilla është e pritshme;	2
Tjera	24

Tabela Nr.4 – Indikatorët e PP/FT të paraqitur në RTD

#### 4.1.2.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta 2011-2015

Të dhënat e analizuar në pesë vitet e fundit tregojnë për një trend në ngritje të numrit të raporteve të transaksioneve të dyshimta të raportuara në NJIF-K. Krahasuar me vitin 2011, numri i RTD-ve thuajse është trefishuar apo është rritur dukshëm në vitin 2015. Krahas trendeve në rritje kuantitative të numrit të RTD-ve, ka tendencë të rritjes edhe të cilësisë së raportimit të transaksioneve të dyshimta, gjë që pasqyrohet edhe me ngritjen e numrit të rasteve të analizuar dhe shpërndara nga NJIF-K.

Grafiku dhe tabela në vijim tregojnë për trendin e raportimeve të bëra në vitet 2011-2015:



Grafiku Nr.7-Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2015

Vitet	2011	2012	2013	2014	2015
RTD-të e pranuar	135	202	174	295	398

Tabela nr.5 - Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2015



Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2015						
Subjektet Raportuese	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithsej 2011-2015
Bankat	129	196	165	234	350	1074
Institucionet Mikrofinanciare	0	0	0	0	2	2
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	0	0	0	1	0	1
Agjensionet për Transfer Parash	3	6	6	58	39	112
Kazinotë	0	0	0	0	0	0
Agjentët e patundshmërive	0	0	0	0	0	0
Avokatët	0	0	0	0	0	0
Noterët	0	0	1	0	0	1
Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor	0	0	0	0	0	0
Auditorët e licencuar	0	0	0	0	0	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	0	0	0	0	0	0
Profesionistët e tjerë	0	0	0	0	0	0
Organizatat Jo-Qeveritare	0	0	0	0	0	0
Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar	0	0	0	0	0	0
Kompanitë e ndërtimit	0	0	0	0	0	0
Dogana e Kosovës	3	0	1	1	4	9
Mbikëqyrësit sektorial	0	0	0	0	2	2
Tjera	0	0	1	1	1	3
<b>Gjithsej RTD-të e raportuar 2011-2015</b>	<b>135</b>	<b>202</b>	<b>174</b>	<b>295</b>	<b>398</b>	<b>1204</b>

Tabela nr.6- Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2015



Kur shikon sektorin financiar në tërësi (që do të thotë bankat dhe institucionet financiare), vërehet qartë se ky sektor mbulon rreth 99 % të numrit të gjithëmbarshtëm të raportimit të transaksioneve të dyshimta. Padyshim që Bankat Komerciale përbëjnë pjesën dërmuese të këtyre raportimeve (89%, 2011-2015), ndërsa institucionet financiare të listuara në paragrafin 1.15 të nenit 2 të ligjit për PPP/PFT përfshijnë rreth 10% të numrit të RTD-ve të raportuar në periudhën 2011-2015, prej nga Agjensionet për Transferim të Parave kanë raportuar rreth 9%. Vetëm 1% e institucioneve tjera financiare (Institucionet Mikrofinanciare, Kompanitë e Sigurimeve, Qiradhënien Financiare, Këmbimoret, Institucionet që merren me investimin, administrimin ose menaxhimin e fondeve apo parave në emër të personave ose subjekteve të tjera etj) apo 3

raporte janë dërguar nga këto institucione në NJIF-K në 5 vitet e fundit.

*Siç kërkohet me nenin 22 të Ligjit për PPP/PFT Bankat dhe institucionet financiare do të raportojnë tek NJIF-K, të gjitha aktet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.*

*Pavarësisht kësaj institucionet tjera financiare mbeten në numra shumë të ulët të raportimit të transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta. Mbetet përgjegjësi e NJIF-K dhe mbikëqyrësve sektorial të jenë më të angazhuar në drejtim të ngritjes së vetëdijes së institucioneve tjera financiare.*

Në lidhje me pjesën tjetër të sektorëve apo subjektet raportuese, shifrat, siç kemi thënë vitet e kaluara, vazhdojnë të jenë modeste. I ashtuquajturit sektori jo-financiar si dhe bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare (BPCJF-të), që nënkupton të gjitha subjektet e mbuluara nga ligji në pajtim me nenin 16 (paragrafët nga 1.3 deri 1.12) të Ligjit për PPP/PFT, kanë kontribuar vetëm pak (që do të thotë vetëm 0.08%) në ngritjen e përgjithshme të Raportevetë Transaksionevetë Dyshimta. Pavarësisht se ky sektor mbulon një game të gjerë të veprimtarive biznesore dhe kanë rendësinë e vet ekonomike, krahasuar me sektorin financiar shifrat mbesin në minimumin e mundshëm.


NJIF-K do të përforcojë edhe më tutje aktivitetet e veta të trajnimit dhe mbikëqyrjes së pajtueshmërisë për të gjitha subjektet raportuese dhe në veçanti për BPCJF-të, për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi. Aktet nënligjoretë miratuara në vitet e fundit nga NJIF-K<sup>2</sup>vetëm se do t'i kontribuojnë zhvillimeve pozitive për vetëdijesimin e profesionistëve në fjalë për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore.

<sup>2</sup>Udhezimi administrativ NJIF-K nr. 05/2014 mbi standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e PP/FT nga profesionistët në fjalë.  
Urdhëresë administrative NJIF-K nr. 02/2015 për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe Indikatorët e PP  
Urdhëresë administrative NJIF-K nr. 03/2015 për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit dhe Indikatorët e FT

## Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) të PP/FT të pranuar nga NjIF-K 2013-2015

Subjekti raportues	2013		2014		2015	
	Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raportet në lidhje me transaksionet e dyshimta	
	PP	FT	PP	FT	PP	FT
<b>BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE</b>						
Bankat Komerciale	159	6	219	15	327	23
Institucionet Mikrofinanciare	0	0	0	0	2	0
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	0	0	1	0	0	0
Agjensjonet për Transfer Parash	6	0	57	1	36	3
Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare	<b>165</b>	<b>6</b>	<b>277</b>	<b>16</b>	<b>365</b>	<b>26</b>
<b>BPPJF-TË DHE ENTITETET TJERA RAPORTUESE</b>						
Kazinotë	0	0	0	0	0	0
Agjentët e patundshmërive	0	0	0	0	0	0
Tregtarët me metale/gurë të çmuar	0	0	0	0	0	0
Avokatët	0	0	0	0	0	0
Noterët	1	0	0	0	0	0
Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor	0	0	0	0	0	0
Auditorët e licencuar	0	0	0	0	0	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	0	0	0	0	0	0
Profesionistët e tjerë	0	0	0	0	0	0
Organizatat Jo-Qeveritare	0	0	0	0	0	0
Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar	0	0	0	0	0	0
Kompanitë e ndërtimit	0	0	0	0	0	0
Gjithsej BPPJF-të dhe Entitetet tjera Raportuese	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>RAPORTET DHE INFORMACIONET TJERA TË DYSHIMTA</b>						
Dogana e Kosovës	0	1	1	0	4	0
Mbikëqyrësit sektorial	0	0	0	0	2	0
Tjera	1	0	1	0	1	0
Gjithsej raportet dhe informacionet tjera	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>7</b>	<b>0</b>
Gjithsejtë RTD e pranuar për PP/FT	<b>167</b>	<b>7</b>	<b>279</b>	<b>16</b>	<b>372</b>	<b>26</b>
<b>Gjithsej RTD e raportuara</b>	<b>174</b>		<b>295</b>		<b>398</b>	


Tabela nr.7 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për PP dhe FT të raportuara në NjIF-K 2013-2015



#### 4.1.3. Transaksionete dyshimta për Financim të Terrorizmit

Marrë për bazë legjislacionin në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018 si dhe planin e performancës dhe resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës, NjIF-K ka qenë i orientuar ta shtrijë aktivitetin e tij në drejtim të ngritjes së efektshmërisë së regjimit raportues dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemit parandalues nga të detyruarit e ligjit.

Përpyekjet e tilla vetëm se kanë konfirmuar rezultat e NjIF-K të orientuara në atë drejtim duke bërë që midis viteve 2013 dhe 2015 numri i RTD-ve të dorëzuara për financim të terrorizmit të trefishohet nga 7 në 26. Kjo rritje e numrit të RTD-ve të pranuar është një zhvillim pozitiv. Kjo pasqyron vigjilencën e subjekteve raportuese dhe një nivel më të lartë të vetëdijes për PPP/PFT në vendin tonë.



Grafiku Nr.8 – RTD të raportuara për Financim të Terrorizmit 2013-2015

Një nga masat parandaluese të ndërmarra nga ana e subjekteve raportuese është edhe njohuria e tyre për zbulimin e transaksioneve jo të zakonshme, të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore dhe përmbajnë në vete dyshime të arsyeshme për financim të terrorizmit. Atëherë kur subjektet e raportimit përcaktojnë se rreziku i pastrimit të parave apo financimi të terrorizmit është ngritur, ata janë të obliguar të ndërmarrin masa të arsyeshme për të mbajtur të azhurnuara informacionet e mbledhura, dhe të zbatojnë masat e arsyeshme të shtuara për të monitoruar profilin e biznesit dhe të rrezikut, duke përfshirë burimin e fondeve, dhe të sigurojnë që të dhënat dhe informacionet e tjera janë mbajtur të azhurnuara.

Gjithashtu, institucionet dhe personat që i nënshtrohen ligjit për PPP/PFT, do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë ndonjë rreziku të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit në lidhje me produktet apo transaksionet që promovojnë anonimitetin dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përdorimin e tij për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

Të dhënat statistikore të regjistruaranga NjIF-K, tregojnë se gjatë vitit 2015, në NjIF-K janë pranuar gjithsej 26 raporte të aktivitetit të dyshimtë për financim të terrorizmit, duke pasuar një ngritje prej rreth 63% krahasuar me një vit më parë (2014: 16). Raportimet për këtë aktivitet gjithnjë në ngritje vazhdojnë të bëhen më së shumti nga bankat, duke përfshirë një rritje të vogël nga agjensionet për transfere të parave.

Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) të raportuara për Financim të Terrorizmit 2013-2015			
Subjekti raportues sipas sektorëve	2013	2014	2015
Bankat Komerciale	6	15	23
Institucionet Mikrofinanciare	-	-	-
Agjensionet për Transfer Parash	-	1	3
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	-	-	-
BPPJF-të	-	-	-
Mbikëqyrësit sektorial	-	-	-
Dogana e Kosovës	1	-	-
Tjera	-	-	-
<b>Gjithsej RTD-të për Financim të Terrorizmit</b>	<b>7</b>	<b>16</b>	<b>26</b>

Tabela nr.8 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për FT te pranuar nga NjIF-K 2013-2015

Një qasje më proaktive e NjIF-K, si dhe ndërmarrja e masave të kujdesit të shtuar nga ana e subjekteve raportuese, vjen në kohën e duhur edhe si rezultat i ngjarjeve globale në rritje të terrorizmit dhe grupeve terroriste dhe kuptohet edhe të ngritjes gjithnjë e më shumë të fondeve që përdoren për aktivitete të financimit të akteve terroriste. Njëherit vlen të veçohet se përveç vlerësimeve sasiore të raportimit të RTD-ve për financim të terrorizmit, ju është kushtuar rëndësi edhe vlerësimit të cilësisë së RAD-ve, e cila ka mund të vije edhe si rezultat që subjektet raportuese janë gjithnjë e më afër njohurive dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të FATF, praktikave më të mira dhe udhëzimeve të lëshuara nga FATF dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Në lidhje me këtë, gjatë vitit 2015, NjIF-K ka publikuar ne uebfaqen e vet edhe udhëzimin e FATF “zbatimi i dispozitave financiare të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për t’ju kundërvënë përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë”<sup>3</sup>.

<sup>3</sup>[http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/06/Udhezuesi\\_i\\_parandalimit\\_te\\_ASHM.pdf](http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/06/Udhezuesi_i_parandalimit_te_ASHM.pdf)



Trendi i zhvillimeve pozitive në drejtim të parandalimit dhe zbulimit të financimit të terrorizmit ka rezultuar edhe me lëshimin nga ana e NjIF-K të një urdhërese administrative<sup>4</sup>, objektivat kryesore të së cilës janë që të:

- *Parandalojë dhe luftojë financimin e terrorizmit si një shtyllë esenciale në luftën kundër terrorizmit;*
- *Definojë listat e aplikueshme të referencës të personave dhe entiteteve të dyshuara për përfshirjen në aktivitetet terroriste, të mirëmbajtur dhe të azhurnuar vazhdimisht nga organizatat ndër-qeveritare dhe qeveritë;*
- *Parandalojë përdorimin e shërbimeve, lehtësirave apo resurseve bankare dhe financiare në Kosovë, nga personat dhe entitetet e dyshuara për financimin e terrorizmit dhe aktivitetet terroriste;*
- *Ofrojë përkrahje për subjektet raportuese duke krijuar listën e indikatorëve të financimit të terrorizmit me qëllim të aplikimit të kujdesit të duhur të shtuar, veçanërisht për bankat dhe institucionet financiare gjatë ushtrimit të bizneseve të tyre.*

Ky akt nënligjor<sup>5</sup>përmban ndër të tjera edhe Indikatorët e financimit të terrorizmit<sup>6</sup> të cilët mund të ndihmojnë subjektet raportuese për të identifikuar aktivitetet potenciale të financimit të terrorizmit. NjIF-K do të mirëmbajë dhe kurdo që është e nevojshme do të përditësojë listën e indikatorëve për financimin e terrorizmit. Këta indikatorë të financimit potencial të terrorizmit parimisht synojnë ngritjen dhe vetëdijesimin e subjekteve raportuese në pajtim me LPP/PFT.

Gjithashtu, urdhëresa administrative ka paraparë edhe listat e personave dhe entiteteve të dyshuar për terrorizëm të cilat lista mirëmbahen për personat dhe entitetet që dyshohen për terrorizëm nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Subjektet raportuese duhet të ushtrojnë kujdes të duhur të shtuar në lidhje me personat dhe entitetet emrat e të cilëve janë të paraqitur në ato lista. NjIF-K ka ofruar lidhje (link) online të listave të tilla nëpërmjet uebfaqes zyrtare elektronik të NjIF-K.

Pa anashkaluar veprimet tjera të ndërmarra, udhëzimet e lëshuara mbi zbatimin e Ligjit për PPP/PFT konsiderohen si pozitive në kontributin e tyre në zbatimin efektiv të regjimit raportues sipas ligjit për PPP/PFT.

---

<sup>4</sup>Urdhëresë Administrative NJIF-K nr. 03/2015 - për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit

<sup>5</sup>[http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/03/Urdh%C3%ABrese\\_Administrative\\_NJIF\\_K\\_03\\_20151.pdf](http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/03/Urdh%C3%ABrese_Administrative_NJIF_K_03_20151.pdf)

<sup>6</sup> <http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2014/10/LISTA-E-INDIKATOR%C3%8BVE-P%C3%8BR-PARANDALIMIN-E-FINANCIMIT-T%C3%8B-TERRORIZMIT.docx>



#### 4.1.4. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)


Raportimi i transaksioneve në para të gatshme përbën volumnin më të mëdh të raportimeve të gjithëmbarshme të pranuar në NJIF-K.

Duke qenë sa më afër përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, Kosova ka të zbatuar në mënyrë efikase sistemin e raportimit të gjitha transaksioneve individuale në para të gatshme e cila duhet të jetë e përcaktuar përmbi një kufi të caktuar. Kufiri i raportimit është përcaktuar në:

- *paragrafit (1.2) të nenit 22 të Ligjit për PPP/PFT që obligon bankat dhe institucionet financiare të raportojnë të gjitha transaksionet individuale në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë*
- *paragrafi (3) i nenit 26 i Ligjit për PPP/PFT, i cili i obligon profesionist në fjalë (avokatët, noterët, kontabilistët dhe auditorët e licencuar dhe këshilltarët tatimor) të cilët, gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin, pranon para nga klienti në shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, për një transaksion ose transaksione të lidhura me të,*
- *paragrafi (3.2) i nenit 28 i Ligjit për PPP/PFT, i cili ndër të tjera i obligon kazinotë dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit se duhet t'i raportojnë NJIF të gjitha transaksionet e vetme në valutë prej 10,000 euro ose më shumë.*

Forma dhe mënyra e raportimit të transaksioneve në para të gatshme është e përcaktuar nga NJIF-K, kjo bazuar në paragrafin 1 të nenit 22, paragrafin 3 të nenit 26si dhe paragrafin 3 të nenit 28 të Ligjit për PPP/PFT. Për këtë qëllim, për subjektet raportuese, në të kaluarën disa herë janë lëshuar udhëzime administrative duke specifikuar me këtë rast format dhe mënyrat e raportimit të cilat që nga viti 2009 janë preferuar të bëhet përmes sistemit goAML.


Shumica e RTG-të e pranuar nga NJIF-K (99%), mbahen dhe menaxhohen në sistemin goAML, bazë e të dhënave elektronike.



Grafiku Nr.9-RTG të pranuar sipas formës dhe mënyrës 2015








Grafiku Nr.10 – Numri i RTG-ve të pranuar 2011-2015

NjIF-K ka pranuar 617,430 RTG në vitin 2015 ose një mesatare prej rreth 51,452 RTG për muaj. Kjo tregon një ngritje prej rreth 12% më tepër se sa në vitin paraprak (2014: 553,651)

Duke krahasuar raportimet e RTG-ve me vitet e kaluara, viti 2015 ka shënuar numrin më të madh të raportimeve, si në numrin e transaksioneve ashtu edhe në numrin e raporteve të dërguara, por shprehur në vlera monetare, raportimi i transaksioneve në para të gatshme ka mbetur i përafërt me vitin e kaluar, duke pësuar një rënie të vogël me rreth 3%.



Grafiku Nr.11 -RTG të pranuar 2011-2015

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
<b>RTG të pranuar</b>	423,443	480,479	606,778	553,651	617,430

Tabela nr.9 -RTG të raportuara për periudhën 2011-2015

Bankat komerciale zënë përqindjen më të lartë të raporteve dhe transaksioneve të raportuara duke mbuluar rreth 86% të numrit të gjithëmbarsëm të raporteve të dërguara në 2015. Këmbimoret përbëjnë rreth 12% të numrit të RTG-ve të dërguara në vitin në fjalë, përderisa Agjensionet për transfer të parave, Institucionet Mikrofinanciare dhe Dogana e Kosovës mbulojnë rreth 2% e këtyre raporteve.

Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranuar				
Subjekti raportues	2014		2015	
	Numri i Raporteve të pranuar	Numri i Transaksioneve	Numri i Raporteve të pranuar	Numri i Transaksioneve
<b>Bankat dhe Institucionet Financiare</b>				
Bankat	1,700	548,139	2,028	614,162
Institucionet Mikrofinanciare	12	37	12	25
Sektori i Sigurimeve	3	11	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	297	2959	292	1875
Agjensionet për Transfer Parash	25	500	23	104
<b>Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare</b>	<b>2,037</b>	<b>551,646</b>	<b>2,355</b>	<b>616,166</b>
<b>Entitetet Tjera Raportuese</b>				
Dogana e Kosovës	12	2005	12	1264
<b>Gjithsej entitetet tjera raportuese</b>	<b>12</b>	<b>2005</b>	<b>12</b>	<b>1264</b>
<b>Gjithsej RTD e pranuar</b>	<b>2,049</b>	<b>553,651</b>	<b>2,367</b>	<b>617,430</b>

Tabela nr.10-Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve'14-'15


#### 4.1.5. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta)

Monitorimi special i transaksioneve të veçanta është obligim ligjor për subjektet raportuese të cilat duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlikuara dhe jashtëzakonisht të mëdha të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore. Raportimi i transaksioneve të tilla është i përshkruar në nenin 20 të ligjit për PPP/PFT.

Trendi i raportimit të transaksioneve jo të zakonshme ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, në të cilin vit janë raportuar gjithsej tri transaksione jo të zakonshme, vlera monetare e të cilave arrin shumën në total deri në € 601,600.

Në tri vitet e fundit, kryesisht raportimi i transaksioneve jo të zakonshme është bërë mbi bazën e kryerjes së transaksioneve të ndërlikuara dhe jashtëzakonisht të mëdha të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore, përderisash subjektet raportuese inkurajohen që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me vendet që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.





**Neni 20 i ligjit për PPP/PFT "Monitorimi special i transaksioneve të veçanta"**

- Subjektet raportuese duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlikuara dhe jashtëzakonisht të mëdha të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore.
- Subjektet raportuese duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridik dhe marrëveshjet ligjore nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshm, standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.
- Subjektet raportuese duhet të paraqesin me shkrim informacionin specifik në lidhje me transaksionet e referuara më lartë, si dhe të identifikojnë të gjitha palët e përfshira. Raporti duhet të ruhet dhe një gjë e tillë duhet të vihet në dispozicion të NJIF-K

Vitet	2011	2012	2013	2014	2015
UTR-të e pranuar	0	0	€419,436	€1,001,320	€601,600

Tabela nr.11- Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme 2011-2015

**4.1.6. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës)**

Dogana e Kosovës e njofton NJIF-K për çdo deklaram ose mosdeklaram të mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga pikat e kalimit kufitar në monedhën euro apo monedha tjera të huaja në qoftë se arrihet pragu prej 10.000 euro ose shumë, si dhe çdo transaksion të dyshimtë ose financimin e dyshuar të terrorizmit që zbulon gjatë kryerjes së detyrave të saj (neni 29i Ligjit për PPP/PFT).

Obligimeve ligjore që dalin nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit 29 të Ligjit për PPP/PFT detyrohen të ju përmbahen çdo person i cili hyn ose del nga pikat e kalimit kufitare në Kosovë, dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, obligohet që të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre. Ky detyrim vlen gjithashtu edhe kur pranohen ose dërgohen fonde jashtë vendit përmes postës apo korrierit komercial, gjithashtu mbi prapun prej dhjetëmijë (10.000) Euro.



Në vitin 2015, janë raportuar në NjIF-K gjithsej 1264 Raporte të Deklarimit Kufitar (RDK), krahasuar me 1250<sup>7</sup>RDK në vitin 2014. Personat fizikë kanë deklaruar mjete në 658 raporte, përdërisa në emër të subjekteve juridike janë deklaruar mjete në 606 raste.

Dogana e Kosovës si zbatuese e kësaj dispozite ligjore, vazhdon të raportojë rregullisht numrin e deklarimeve të tilla.

Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare			
Numri i Raporteve të deklaruara			
Vitet	Personat Juridik	Personat Fizik	Numri i deklarimit te RDK-ve
1	2	3	4 = (2+3)
2015	606	658	1,264
2014	667	583	1,250
2013	553	543	1,096
Gjithsej	1,826	1,784	3,610

*Tabela nr.12 - Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2015*

Përveç deklarimit të zakonshëm të mjeteve monetare, Dogana e Kosovës ka njoftuar NjIF-K edhe për mosdeklarim të mjeteve monetare. Gjoha e shqiptuar me këtë rast është 25 % të shumës së mjeteve monetare të padeklaruara në posedim të tij/saj për të cilat ka detyrim për të deklaruar. Në vitin 2014, NjIF-K është njoftuar në lidhje me shqiptimin e 5 gjobave për mosdeklarim të mjeteve monetare. Vlera e gjobave të shqiptuara ka qenë 29,941 € dhe 5,000 USD.

Në zbatim të nenit 29 paragrafit 10 të Ligjit për PPP/PFT, NjIF-K ka pranuar nga Dogana e Kosovës katër (4) raporte të transaksioneve të dyshimta aty ku ka pasur bazë për dyshim të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

#### 4.1.7. Ngrirja e transaksioneve bankare

Në mbështetje të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, NjIF ka autoritetin për të urdhëruar pezullimin e një transaksioni, ku ka dyshime se transaksioni apo fondet në llogari janë të lidhura ose janë produkt i krimit, pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Pezullimi i një transaksioni lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë pas njoftimit nga subjekti raportues mund të bëhet për një kohë maksimale prej dyzetetë (48) orëve.

Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit	2014	2015
Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit	20	6
Shuma (EUR)	774,115.00	29,739.93

*Tabela nr.13 -Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit*

<sup>7</sup>1250 Raporte përfshijnë 2005 transaksione individuale në para të gatshme



#### 4.1.8. Kërkesat e OJQ-ve për përijashtim nga ndalesat ligjore

Organizatat Jo-Qeveritare si subjekte raportuese të përcaktuara në Ligjin Nr. 03L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178, përveç obligimeve tjera, janë paraparë të kenë edhe detyrime shtesë për OJQ të specifikuara në nenin 24 të ligjit në fjalë, i cili ndër të tjera u kërkon atyre t'u përmbahen obligimeve si në vijim:

- *Paragrafi 1 i Nenit 24 përcakton që OJQ-ja nuk mund të pranojë kontribute në para që tejkalojnë njëmijë (1,000) Euro nga një burim i vetëm brenda një (1) dite të vetme si dhe*
- *Paragrafi 2 i Nenit 24 përcakton që OJQ-ja nuk mund të paguajë para që tejkalojnë pesëmijë (5,000) Euro brenda një (1) dite të vetme cilitdo marrësi të vetëm.*
- *Paragrafi 3 i Nenit 24 të ligjit në fuqi mundëson që për të qenë në gjendje që të bëjnë ose pranojnë pagesa që i tejkalojnë shumat e cekura më sipër, OJQ-ja mund të kërkojë nga NjIF-K:*
  - o *lirimin e njëhershëm, ose*
  - o *lirim të vazhdueshëm nga këto ndalesa.*
- *Kërkesa me shkrim që dorëzohet nga OJQ tek NjIF-K duhet të potencojë llojin e kërkuar të lirit dhe arsyet për këtë lirim, ndërsa NjIF-K duhet t'i përgjigjet kësaj kërkesë brenda 30 ditësh.*
- *Përgjigjet e NjIF-K mund të jenë:*
  - o *1) lejohet;*
  - o *2) lejohet me kusht;*
  - o *3) refuzohet lirimi.*
- *Kërkesa drejtuar NjIF-K është mënyra e përcaktuar ligjore për t'u përjashtuar nga kufizimet e neneve 24.1 dhe 24.2.*

Numrii kërkesave të pranuar dhe proceduar në NjIF-K në vitin 2015 ka qenë i përafërt me një vit më parë, ku nga Njësiat janë proceduar gjithsej 15 kërkesa për lirim të njëhershme ose të vazhdueshme dhe janë kthyer përgjigje tek OJQ-të.

Kërkesat e OJQ-ve për lirim nga paragrafi (1) dhe (2) i nenit (24)	2014			2015		
	Përgjigjet e NjIF-K			Përgjigjet e NjIF-K		
	Kërkesë e Njëhershme	Kërkesë e Vazhdueshme	Gjithsej 2014	Kërkesë e Njëhershme	Kërkesë e Vazhdueshme	Gjithsej 2015
Të Liruara	2	5	7	2	2	4
Të Liruara me kusht	3	3	6	4	6	10
Të Refuzuara	2	1	3	0	1	1
<b>Gjithsej Kërkesat e shqyrtuara nga NjIF-K</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>16</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>15</b>

Tabela nr.14 -Kërkesat e OJQ-ve për lirim të njëhershëm apo të vazhdueshëm

## 4.2. Analizimi dhe Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet vendoredhe homologët ndërkombëtar


### 4.2.1. Analizimi i raporteve të inteligjencës

Gjatë vitit 2015, NjIF-K ka hapur gjithsej 247 raste për analiza financiare nën dyshimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo veprave tjera të ndërlidhura. Rreth 51 % e rasteve të hapura në këtë vit kanë rrjedhur nga raportet e transaksioneve të dyshimta, përderisa kërkesat për informata përbëjnë rreth 43% të numrit total të rasteve të hapura gjatë këtij viti raportues. Rastet e tjera mbesin në numra të përafërt me vitet e kaluara.

Viti 2015 është karakterizuar me ngritjen më të madhe (që nga themelimi i NjIF-K) të numrit të rasteve të hapura nga informacionet e marra nga transaksionet e dyshimta (RTD). Gjithashtu në vitin 2015, kishte një ngritje prej rreth 62 % krahasuar me vitin e kaluar të numrit të rasteve të hapura bazuar në RTD, përderisa në total kishte një rënie prej rreth 10.50 % krahasuar po me vitin e kaluar. Kjo rënie numrit të rasteve të hapura ka ardhur si rezultat i zvogëlimit të kërkesave për informata sidomos nga shkëmbimi i informacioneve me autoritetet vendore.

Rritja e numrit të rasteve të hapura nga transaksionet e dyshimta të raportuara në NjIF-K ka ardhur edhe si rezultat i ngritjes së numrit të RTD-ve, përderisa dallimi në mes të numrit të RTD-ve dhe numrit të rasteve të hapura i referohet edhe rasteve në të cilat më shumë se një RTD ishte raportuar për persona apo subjekte të ngjashme në periudha të ndryshme kohore.

Përveç rasteve të hapura bazuar në RTD (125) dhe kërkesat për informata (106), NjIF-K ka gjeneruar edhe 16 raste, të cilat janë iniciuar pas marrjes së informata nga burime të ndryshme. Një nga këto raste është hapur nga NjIF-K pas informacionit spontan të dërguar nga një NJIF homologe. Prandaj, numri i përgjithshëm i rasteve të reja të hapura për analizim nga NjIF-K gjatë vitit 2015 ka arritur në 247.



Grafiku Nr.13 -Rastet e Hapura për analizim 2015

Rastet e Hapura	2014	2015	+/-
<b>Rastet e hapura bazuar në RTD</b>	77	125	+62.34%
<b>Rastet e hapura nga NjIF-K (informacioni anonim)</b>	14	14	0.00%
<b>Rastet e hapura nga Informatat Spontane nga FIU tjera</b>	1	1	0.00%
<b>Kërkesat per informata</b>	182	106	-41.76%
<b>Projektet e përbashkëta te analizave/hetimeve me Institucionet tjera te zbatimit te ligjit</b>	2	1	-50.00%
<b>Gjithsej Rastet e Hapura</b>	<b>276</b>	<b>247</b>	<b>-10.51%</b>

Tabela Nr.15 -Rastet e Hapura 2014-2015

#### 4.2.2. Hapja e rasteve me iniciativë të NjIF-K


NjIF-K është e autorizuar të pranojë dhe procedojë, të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet;

- të bëra dhe të ruajtura sipas neneve 16 deri në 28 të ligjit për PPP/PFT;
- që i janë ofruar NjIF-K-së nga NjIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare; dhe/ose
- që i janë ofruar vullnetarisht NjIF-K-së në lidhje me dyshimet për shpëlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terrorist.

Një qasje sa më proaktive në drejtim të zhvillimeve dhe ngjarjeve të lidhura me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit ka qenë e shprehur edhe gjatë vitit 2015, duke marrë iniciativë për propozimin e rasteve që ndërlidhen me dukurit negative të PP/FT. Në dy vitet e fundit është shënuar progres i theksuar për propozimin e rasteve të iniciuara nga vetë NjIF-K.

Propozim për hapje te rasteve me initiative te NjIF-K	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Rastet e Propozuara</b>	6	5	0	52	40

Tabela Nr.16 – Rastet e hapura me initiative të NjIF-K 2011-2015




Grafiku Nr.14 – Rastet e propozuara për t'u hapur me iniciativë të NjIF-K 2011-2015

Pjesa më e madhe e rasteve në këtë vit kanë ardhur me propozime pas analizimit të rregullt të raporteve në para të gatshme (70%), përderisa informacioni i ofruar vullnetarisht NjIF-K-së në lidhje me dyshimet për pastrim të parave ose financimit të aktiviteteve terroriste mbetet i përafërt me vitin e kaluar. Informacioni spontan i dërguar nga NjIF ndërkombëtare mbetet në numër jo shumë të lartë, kurse informacionet e marrura nga media dhe institucionet publike nuk dallojnë shumë me vitin e kaluar.

Propozim për hapje të rasteve me iniciative të NjIF-K	2015	%
Propozim për hapje të rasteve bazuar në analizimin e RTG-ve	28	70.00%
Informacioni i marr nga Institucionet Publike	2	5.00%
Propozim për hapje të rasteve bazuar në informacionet e marruara nga mediat	2	5.00%
Informacioni spontan i dërguar nga NjIF ndërkombëtare	1	2.50%
Inspektim i Pajtueshmërisë	1	2.50%
Informacioni i ofruar vullnetarisht NjIF-K-së në lidhje me dyshimet për shpëlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste	6	15.00%
<b>Gjithsej Rastet e Hapura</b>	<b>40</b>	<b>100.00%</b>

Tabela Nr.17 - Rastet e inicuar dhe propozuara me iniciativë të NjIF-K sipas burimit 2015



Grafiku Nr.15 - Rastet e inicuar dhe propozuara me iniciativë të NjIF-K sipas burimit 2015





#### 4.2.3. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës

Bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-196, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 për PPP/PFT, NjIF-K bën shpërndarjen e informacionit dhe dokumenteve tjera zyrtare për hetim të mëtutjeshëm tek organet tjera kompetente me qëllim të ofrimit të bazës për hetim. Në këtë drejtim, me qëllim të shpërndarjes së rezultatit përfundimtar, NjIF-K publikon dhe shpërndan informacione dhe raporte të inteligjencës për institucionet e zbatimit të ligjit në vend ose për organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe jashtë Kosovës që kryejnë funksion të ngjashëm me NjIF-K, kjo si rezultat i përpunimit dhe analizimit të raporteve dhe informacioneve të raportuara nga: subjektet e ligjit, që i janë dërguar njësisë si informacion spontan nga FIU e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, që i janë ofruar vullnetarisht njësisë, të dhënat e grumbulluara dhe që është në dispozicion publik dhe që kanë lidhje me shpërlarjen e parave ose financimin e aktiviteteve terroriste, si dhe pas kërkesave për informacion shtesë nga subjektet raportuese.

Një zhvillim të rëndësishëm për vitin 2015 përbën rritja e numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndara (94) tek institucionet tjera, duke shënuar progresin më të lartë të raporteve të shpërndara në pesë vitet e fundit. Duke e krahasuar me vitin paraprak në të cilin janë shpërndarë gjithsej 59 raporte, viti 2015 ka rezultuar me një ngritje prej rreth 59% duke tejkaluar njëherit edhe objektivat e përcaktuara në planin e performances së NjIF-K dhe treguesit kyç të performances së Strategjisë Kombëtare 2014-2018, të cilat kanë paracaktuar 80numrin minimal të raporteve të inteligjencës të shpërndara në autoritetete mandatuara për vit kalendarik 2015.

Për më tepër Raporti i Progresit të BE 2015 ka theksuar se *“Ka pasur një rritje të numrit të rasteve kundër shpërlarjes së parave që i janë përcjellë prokurorisë. Megjithatë, deri më tash janë dhënë vetëm disa dënime”*.

Raportet e shpërndara të inteligjencës/referuar në	2015	%
Policia e Kosovës	42	45%
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	9	10%
Administrata Tatimore e Kosovës	23	24%
Dogana e Kosovës	6	6%
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	4	4%
Agjencia Kundër Korrupsionit	1	1%
EULEX	1	1%
Fiu ndërkombëtare	8	9%
<b>Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës</b>	<b>94</b>	<b>100%</b>




Tabela Nr.18 - Raportet e inteligjencës të shpërndara referuar në institucione përkatëse 2015

Rezultatet e të dhënave statistikore kanë treguar se rreth 87% e raporteve të përgjithshme të shpërndara në vitin 2015 kanë qenë të dyshuara për pastrim të parave ose veprave të


ndërlidhura penale, përderisa rreth 13% janë shpërndarë nën dyshimin e financimit të terrorizmit.

Pavarësisht zvogëlimit të kapaciteteve të NjIF-K dhe numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve që punojnë në analiza financiare, implementimi i dokumenteve strategjike dhe krijimi i planit të performancës dhe resurseve të NjIF-K 2015-2017 ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e performacës në vitin 2015 krahasuar me vitet e mëparshme..

Shpërndarja raporteve të inteligjencës tek agjencionet tjera vendore dhe ndërkombëtare për periudhën pesëvjeçare 2011 – 2015, është paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Raportet e inteligjencës të shpërndara /referuar në:	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithsej 2011-2015
Policia e Kosovës	22	25	44	27	42	160
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	0	1	0	1	9	11
Administrata Tatimore e Kosovës	6	17	21	21	23	88
Dogana e Kosovës	2	5	4	2	6	19
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	0	0	0	0	4	4
Agjencia Kundër Korruptionit	0	0	0	0	1	1
EULEX	8	7	2	2	1	20
Fiu ndërkombëtare/Informacion Spontan	4	0	3	6	8	21
Tjera	1	0	0	0	0	1
<b>Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës</b>	<b>43</b>	<b>55</b>	<b>74</b>	<b>59</b>	<b>94</b>	<b>325</b>

Tabela Nr.19 - Raportet e inteligjencës të shpërndara referuar në institucione përkatëse 2011-2015



Grafiku Nr.17 - Raportet e inteligjencës të shpërndara në periudhën 2011-2015



#### 4.2.4. Kërkesat për informata nga institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar


NjIF-K obligohet që në harmoni me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bashkëpunojë në mënyrë reciproke me institucionet zbatuese të ligjit si dhe organet tjera në Kosovë, të ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe t'i koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme. Një bashkëpunim i tillë ndër-institucional përveç se ka shënuar rritje të numrit të informatave të shkëmbyera, ka shënuar progres dhe ngritje të kapaciteteve profesionale.

Kapacitetet e NjIF-K përveç tjerash, janë të përqendruara edhe në drejtim të pranimit dhe kthimit të përgjigjeve sipas kërkesave për informata dhe bashkëpunimin mes institucioneve të zbatimit të ligjit me qëllim të ofrimit të ndihmës gjatë hetimeve. Ngritja e tillë e bashkëpunimit ka rrjedhur si rezultat i ngritjes së vetëdijes për ndërlidhjen e veprave penale. Rezultat i kësaj është edhe shkëmbimi i zyrtarëve ndërlidhës ku gjatë fillimit të vitit 2015, një zyrtar ndërlidhës nga Policia e Kosovës është zhvendosur në objektet e NjIF-K dhe gjithë kapacitetet e tij janë fokusuar në shkëmbim të informacioneve në mes të NjIF-K dhe Policisë së Kosovës. Gjithashtu edhe një zyrtar nga NjIF-K është caktuar të jetë person ndërlidhës mes NjIF-K dhe ILECU's.

Parashtrimi i kërkesave për informata zakonisht bëhet kur gjatë kryerjes së detyrave të tyre, autoritetet hetuese mund të hasin në veprat penale të cilat mund të jenë të ndërlidhura qoftë me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, dhe falë një bashkëpunimi të ndërtuar vite me radhë, e njoftojnë NjIF-K për dyshimet e ngritura. Në pajtim me kërkesën e parashtruar dhe në përputhje me rrethanat, njësia mund të fillojë me përpunimin analitik të transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta, si dhe mund ta refuzoj kërkesën e tillë nëse vëren se rasti nuk ka të bëjë me elementet e dyshimit për PP/FT ose veprave të ndërlidhura penale.

Në vitin 2015, janë pranuar gjithsej 128 kërkesa për shkëmbim të informacioneve, kërkesa që janë parashtruar qoftë nga autoritetet hetuese vendore (86%) ose nga homologët tonë ndërkombëtarë (14%). Gjatë vitit 2015 vetëm dy kërkesa janë refuzuar nga NjIF-K.

Sikurse në vitet e mëparshme, Policia e Kosovës mban primatin e numrit më të madh të kërkesave të bëra nga autoritetet vendore (me rreth 47%), të përcjella pastaj nga Dogana e Kosovës (14%), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (17%), ATK (2%), Prokuroria (5%), EULEX (7%), ILECU's (5%) etj.




Grafiku Nr.18 - Kërkesat për informata të pranuar 2015

Në tabelën në vijim janë paraqitur kërkesat për informata nga autoritet vendore dhe ndërkombëtare:

Kërkesat për informata të pranuar në NjIF-K	2011	2012	2013	2014	2015
Numri i kërkesave për informata të pranuar nga autoritetet vendore	64	103	183	177	110
Numri i kërkesave për informata të pranuar nga FIU homologe të huaja	10	10	7	19	18
Total kërkesat për informata të pranuar në NjIF-K	<b>74</b>	<b>113</b>	<b>190</b>	<b>196</b>	<b>128</b>

Tabela Nr.20 -Kërkesat për informata të pranuar në NjIF-K 2011-2015



Grafiku Nr.19 -Kërkesat për informata të pranuar në NjIF-K 2011-2015

Një nga detyrat dhe kompetencat e NjIF-K-së është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Neni 14 i Ligjit për PPP/PFT paragrafi 1.7 specifikon se NjIF-K është e autorizuar që spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionet me çdo agjenci homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e agjencisë e cila i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të shpëlarjes së parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

Dy vitet e fundit kanë rezultuar me ngritje të bashkëpunimit ndërkombëtar, kontribuesi së cilës ishte edhe pjesëmarrja e NjIF-K, qoftë në takime rajonale apo ndërkombëtare (pjesëmarrja si vëzhgues në Egmont Grup).

Kthimi i përgjigjeve për institucionet që parashtruan kërkesat është bërë në afatet sa më të shkurtra kohore, ku pas pranimit dhe procedimit të informatave të tilla dhe pasi të dhënat janë kompletuar apo analizuar nga ana e NjIF-K, bëhet shpërndarja e raporteve të inteligjencës varësisht nga dyshimi i ngritur për pastrim të parave, financim të terrorizmit ose veprave penale të ndërlidhura.



Përgjigje në Kërkesat për Informata	2011	2012	2013	2014	2015
Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek autoritetet vendore	71	104	174	174	92
Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek FIU homologe të huaja	11	13	5	20	18
Total kërkesat për informata të shpërndara nga NjIF-K	82	117	179	194	110

Tabela Nr.21 - Kërkesat për informata të shpërndara ose përgjigjur nga NjIF-K 2011-2015

Detajet më të hollësishme për shkëmbimin ndërkombëtar të informacioneve mund të shihen tek kapitulli “Bashkëpunimi me homologët e huaj”.

#### 4.3. Inspektimi për pajtueshmëri

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me obligimet ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit mbetet një ndër funksionet kryesore të Njesisë për Inteligjencë Financiare.

Bazuar në analizën e rrezikut të pajtueshmërisë, inspektimet janë orientuar ndaj atyre sektorëve të cilët më së paku kanë raportuar në NjIF-K si këmbimoret, kompanitë e sigurimeve dhe OJQ-të.

2015					
Subjektet raportuese	Lloji inspektimit				
	Fushëveprimi i plotë	Fushëveprimi i kufizuar	Inspektim Pasues	Ad-Hoc	Gjithsej
Banka		1	5	1	7
Institucione Mikrofinanciare	1	1	1	//	3
Kompani të Sigurimit	3	//	//	//	3
Kompani të Sigurimit të Jetës		//	//	//	0
Zyrat e Këmbimit Valutor	3	//	2	//	5
Agjensione për transfere të parave		1	1	//	2
OJQ	4	//	//	1	5
Auditor & Kontabilistë	1	//	//	//	1
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë	12	3	9	2	26

Tabela nr.22 –Inspektimi për Pajtueshmëri 2015

Gjatë vitit 2015 NjIF-K ka realizuar inspektime pasuese me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së rekomandimeve të lëshuara nga NjIF-K gjatë vitit 2014. Gjithashtu, janë realizuar edhe inspektime në vend me fushëveprim të plotë, inspektime me fushëveprim të kufizuar si dhe inspektime Ad-Hoc. në bazë të nenit 36.A. të Ligjit Nr. 03/L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 për “Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të



Terrorizmit” dhe nenit 6 të “Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin dhe Shkëmbimin e Informatave të nënshkruar në mes të NjIF-K dhe BQKNjIF-K ka autorizuar Bankën Qendrore të Kosovës të realizoj ekzaminime të pajtueshmërisë në bankat dhe institucionet tjera financiare.

Në vijim paraqesim disa nga mangësitë e identifikuara gjatë inspektimeve për pajtueshmëri:

- Mungesa e identifikimit të klientëve;
- Mungesa e mbajtjes dhe ruajtjes së shënimeve ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi;
- Mungesa e monitorimit të klientëve me rrezikshmëri të lartë;
- Mungesa e identifikimit të klientëve PEP.

Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014 - 2015		
Subjektet raportuese	2014	2015
Banka	9	7
Institucione Mikrofinanciare	5	3
Kompani të Sigurimit	4	3
Kompani të Sigurimit të Jetës	2	0
Zyrat e Këmbimit Valutor	7	5
Agjensione për transfere të parave	3	2
OJQ	5	5
Auditor & Kontabilistë	0	1
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë	35	26

Tabela nr.23 –Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014-2015

#### 4.4. Informatat kthyesë

##### 4.4.1. Informatat kthyesë nga Institucionet e zbatimit të ligjit

Në vitin 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj ka dënuar 3 persona për shkak të përfshirjes në veprat penale si Krimi i organizuar nga neni 274 të KPK-së lidhur me veprat penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 KPK-së dhe shpërlaja e parave nga neni 32 i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (Ligji Nr 03/L-196).

Këta persona janë dënuar me rreth 19 vite burgim dhe rreth 90,000 € gjobë si dhe konformë nenit 276 të KPP-së lidhur me nenin 82 të KPK-së, konfiskohet pasuria në mënyrë të përhershme, meqë është vërtetuar se është dobi pasurore e fituar nga kryerja e veprave penale vlera e së cilës ishte mbi 1 milion euro.

Numri i informatave kthyesë të pranuar nga NjIF-K gjatë vitit 2015 ka shënuar rënie krahasuar me një vit më herët. Gjithsej 33 informata kthyesë janë transmetuar nga agjencionet e zbatimit të ligjit tek NjIF-K në lidhje me rastet e referuara nga NJIF-K në vitet 2010-2015. Administrata



Tatimore e Kosovës vazhdon të transmetojë informata në mënyrë sistematike duke përcjell në vitin 2015 gjithsej 16 informata kthyese përmes së cilave është njoftuar NJIF-K për rezultatet e hetimeve të ndërmarra në lidhje me rastet e shpërndara nga njësia në vitet e kaluara. Hetimet e ndërmarra nga ATK gjithashtu kanë treguar se në disa nga këto raste ka pasur shmangie tatimore ose mosdeklarim real të qarkullimit që arrijnë në vlerë prej rreth 571,000 Euro.

Policia e Kosovës (DSAK) ka njoftuar NJIF-K se në 14 raste janë në proces të zhvillimit të hetimeve për veprat e ndërlidhura me pastrimin e parave.

#### 4.5. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIF-K), bazuar në nenin 14 paragrafi 1.10 të Ligjit Nr. 03/L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, në kuadër të mandatit ligjor ka kompetencë të organizojë dhe/ose kryej trajnime në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste, obligimet ligjore të subjekteve raportuese dhe në përgjithësi me vetëdijesim dhe sensibilizim në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese.

Nga ana e subjekteve raportuese në kuadër të kornizës ligjore përcaktohet edhe obligimi i sigurimit, organizimit dhe financimit të programit për trajnimin dhe aftësimin e të punësuarve mbi përgjegjësitë e parapara me ligj, andaj NJIF-K bashkëpunon me subjektet raportuese për organizim të trajnimeve të përbashkëta.

Në kuadër të vitit 2015, NJIF-K e ftuar nga Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovë ka ofruar përkrahje për Shoqata duke marrë pjesë si ligjërues nga zyrtar të NJIF-K në trajnime të organizuara për stafin e institucioneve mikrofinanciare me qëllim të rritjes së vetëdijesimit sa i përket implementimit të legjisllacionit në fuqi për këtë fushë. Trajnimet janë organizuar si në vijim:

Data	Subjekti raportues	Tema	Organizator	Nr.i pjesëmarrësve
16/01/2015	Institucionet Mikrofinanciare	Parandalimi i pastrimit të parave dhe parandalimi i financimit të terrorizmit	Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare	13
26/03/2015	Institucionet Mikrofinanciare	Parandalimi i pastrimit të parave dhe parandalimi i financimit të terrorizmit	Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare	33
22/10/2015	Institucionet Mikrofinanciare	Parandalimi i pastrimit të parave dhe parandalimi i financimit të terrorizmit	Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare	15
16/10/2015	Kompani e Sigurimeve	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	Kompania e Sigurimeve Scardian	5

Tabela nr.24 –Trajnimet për subjektet raportuese 2015

Gjithashtu në vitin në shqyrtim, stafi i NJIF-K ka mbajtur prezantime në 5 trajnime, konferenca dhe seminaretë mbajtura për agjensionet e zbatimit të ligjit. Organizues të këtyre aktiviteteve



janë kryesisht Instituti kundër krimeve ekonomike, IGJK, OSBE etj. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete ka qenë mbi 100 zyrtarë shtetëror.

#### **4.6. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes**

Takimet me subjektet raportuese për qëllim të informimit të tyre si dhe forma tjera të takimeve kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Përveç takimeve individuale, NjIF-K ka mbajtur takime dhe në kuadër të shoqatave sipas sektorëve specifik, duke përfshirë këtu takimet me Shoqatën e Bankave, Shoqatën e Noterëve, Oden e Avokatëve, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare, Shoqatën e Kompanive të Sigurimit etj.

NjIF-K dhe Shoqata e Bankave kanë rënë dakord për mbajtjen e takimeve të rregullta tremujore në të cilat janë diskutuar tema specifike të rastit si dhe tema tjera me interes të përbashkët. Rezultatet nga këto takime janë vlerësuar shumë pozitive si në aspekt të shtjellimit të temave të ndryshme, po ashtu edhe në drejtim të ngritjes së vetëdijes.

Gjithashtu me qëllim të informimit më të drejtë të palëve të interesit dhe mbajtjen e marrëdhënieve me publikun, puna dhe aktivitetet e NjIF-K janë orientuar në drejtim të informimit të opinionit qoftë përmes takimeve me agjensionet e zbatimit të ligjit, takimet me shoqatat e ndryshme, palët e treta etj.

Për të mbuluar objektivin e ngritjes së vetëdijes, NjIF përdor mënyra të ndryshme për informim palët e interesit dhe publikun e gjerë. Në mënyrë të veçantë ajo është e fokusuar në:

- ✓ prezantimin e aktivitetit të saj në konferenca, seminare, kurse dhe trajnimet të lidhura me PPP/PFT,
- ✓ publikimin e njoftimeve dhe ngjarjeve në faqen e internetit<sup>8</sup> të NjIF-K,
- ✓ publikimin e raporteve vjetore, tipologjive, statistikave, indikatorëve etj,
- ✓ intervistave dhe deklarimeve për media,
- ✓ publikimin e udhëzimeve dhe ligjeve, standardeve ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.
- ✓ etj.

#### **4.7. Publikimi i Raportit Vjetor dhe Tipologjive**

Ky është viti i pestë (5) në të cilin NjIF-K bënë publikimin e raportit të saj vjetor përmes së cilave janë njoftuar palët e interesit me të dhënat dhe aktivitetet e njësisë. Në rend të parë raporti i është dedikuar Bordit Menaxhues të NjIF-K, pastaj subjekteve raportuese, institucioneve publike, palëve të treta dhe gjithë atyre që kanë shfaqur interes të lexojnë.

Secilin vit, raporti vjetor i NjIF-K është pasuruar me të dhëna dhe shënime statistikore duke ofruar edhe shifra krahasuese.

Publikimi i tipologjive të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dy vite më parë, është bërë me qëllim të ngritjessë vetëdijes dhe të kuptuarit e fenomeneve të pastrimit të parave dhe

---

<sup>8</sup><http://fiu.rks-gov.net/>





financimit të terrorizmit. Kjo ka ndikuar në ngritje e kualitetit të raporteve të dyshimta të raportuara nga subjektet raportuese. Njëkohësisht publikimi i raporteve të tilla ka ngjallur interesimin për ofrimin vullnetar të informacioneve për dyshimet në lidhje me shpëlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste apo veprave të ndërlidhura penale.

Publikim i raporteve vjetore dhe tipologjive do të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme duke ofruar vazhdimësitë të dhënave statistikore dhe aktiviteteve të zhvilluara në lidhje me NjIF-K, si dhe duke përfshirë edhe raste dhe situata tjera ilustruese me indikatorë të ndryshëm të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe me qëllim të zbulimit dhe luftimit të dukurive negative të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.



Tipologjitë e paraqitura përmes këtij raporti, poashtu do të jenë në ndihmë të subjekteve raportuese për të kuptuar natyrën e PP/FT dhe kërcënimeve të tyre, ku në mes tjerash do të jenë në mbështetje të dizajnit të strategjive efektive për të trajtuar këto kërcënime.

Këto tipologji gjithashtu u ndihmojnë edhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit për të hetuar dhe ndjekur personat e përfshirë në PP dhe FT, si dhe hartimin dhe zbatimin e masave efektive parandaluese.


#### 4.7.1. Tipologji

##### Rasti 1

Njësia për Inteligjence Financiare ka pranuar një RTD nën dyshimin se Personi S ka realizuar disa here transfere ndërkombëtare të dërguara në një nga vendet offshore (Shteti "Y"). Para kryerjes së këtyre transfereve, personi në fjalë ka kryer deponime të mjeteve në vlera të konsiderueshme në llogari të një biznesi (Kompania 2) të hapur në emër të tij. Transferimi i mjeteve është bërë në emër të një fature të ngjashme të paraqitur gjithmonë para kryerjes së këtyre transaksioneve.

Vetëm disa ditë më vonë është raportuar edhe një RTD tjetër, i cili ndër të tjera thekson se në emër të një Kompanisë 1 me pronar Personin G (shtetas i Vendit X) janë duke u kryer transaksione tepër të dyshimta, ku fillimisht janë vërejtur depozitime në shuma të mëdha dhe transfertat të menjëhershme në Shtetin "Z". Gjatë analizave të kryera nga NjIF-K është vërejtur që një person tjetër (Personi M) i cili duket se është bashkëvendës i personit të sipërpërmendur, ka hapur një llogari në emër të tij dhe po të njëjtën ditë ka depozituar një shumë të mjeteve prej 70,500 € të cilat menjëherë i ka transferuar në Shtetin "Z" tek llogaria bankare dhe kompania e njëjtë përfituese i ngjashëm me transferin e kryer nga Personi G. NjIF-K ka bërë kërkesë për informata në njësinë homologe në Shtetin X dhe në përgjigjen e tyre thuhet se personat në fjalë nuk janë shtetas të këtij shteti. Kjo përgjigje ka ngritur edhe më tepër dyshimet tek NjIF-K, ku është konkluduar se personat e dyshuar kanë bërë falsifikim të dokumenteve dhe me këto të dhëna të falsifikuara kanë kryer transaksione të dyshimta.

Me të hasur në këto dhëna, NjIF-K ka bërë kërkesë për informata në FIU homologe në Shtetin “Z”, dhe në përgjigjen e tyre të menjëhershme shpaloset informacioni se po në këtë shtet (Shtetin “Z”) është raportuar një RTD për Personin M. Ky person kryente transaksione të dyshimta edhe në vende tjera duke tërhequr, strukturuar dhe bartur fonde në vendet dhe kompanitë kryesisht offshore.



#### Indikatorët:

- ❖ Transfere ndërkombëtare të fondeve nga llogaria individuale te disa llogari “offshore” të mbajtura nën të njëjtin emër
- ❖ Përdorimi i bizneseve fiktive, përfshirë kompanitë “offshore”
- ❖ Pagesat përmes llogarive përdoren në mënyrë të vazhdueshme për fondet me origjinë nga jashtë. Këto fonde më pastaj janë transferohen shpejt në llogaritë e kompanive në vendet e njohura si “parajsat” tatimore apo qendrat offshore;
- ❖ Depozitime të mëdha në para në të gatshme të bëra në llogarinë individuale apo të personit juridik ku normalisht aktiviteti i biznesit të individit apo personit juridik mund të bëhet në metoda tjera të pagesës
- ❖ Përdorimi i dokumenteve false




## Rasti 2

Gjatë analizës kemi vërejtur se Z. BP si klient i rregullt i institucionit gjatë vitit 2014-2015 ka kërkuar kredi te vazhdueshme për bujqësi në vlerë 25,000.00.

Këtë Kredi personi në fjalë e kthen para afatit të caktuar për kthim të kredisë me para në të gatshme dhe menjëherë kërkon për vazhdim të kredisë me po të njëjtën vlerë 25,000.00EUR.

Dyshimi jonë qëndron në faktin se z.BP e kthen kredinë për afat të shkurtë kohor afat ky gjatë të cilit nuk mund të gjenerohen menjëherë paratë për një subjekt që ka veprimtari bujqësinë - meqë duhet të pritet për produktin final. Andaj dyshojmë në origjinën e fondeve të BP me të cilat e kthen kredinë.



### Indikatorët specifik:

- ❖ Investime të mëdha në patundshmëri duke përdorë kredive të pasuara nga shlyerja e shpejtë dhe e hershme e parave të tërhequra;
- ❖ Shlyerja e kredisë përmes depozitimeve në para në të gatshme, jo-proporcionale me të ardhurat zyrtare të palëve të përfshira
- ❖ Fatura Fiktive



## 4.8. Ngritja e kapaciteteve të NjIF-K

### 4.8.1. Teknologjia Informative



NjIF-K ka sisteme të TI-së që funksionojnë mirë për analiza, raportim dhe shpërndarje të dhënave. Njësia është duke e përdorur sistemin goAML, një softuer që është i dizajnuar ekskluzivisht për punët dhe operacionet e Njësive të Inteligjencës Financiare.

Në vitin 2014, NjIF-K ka krijuar sistemet elektronike të shkëmbimit të informatave me Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Agjencionin e Regjistrimit Civil. Këto lidhje të të dhënave kanë siguruar një përdorim më efikas të informatave në luftimin dhe parandalimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe veprave penale bazë.

NjIF-K e ka zhvilluar uebfaqen për të komunikuar me subjektet raportuese në mënyrë shumë efikase.

NjIF-K ka realizuar me sukses buxhetin vjetor të Njesisë të ndarë për TI dhe nuk kemi poseduar buxhet shtesë në Investimet Kapitale. Nuk ka pasur investimet në Harduer (Kompjuterët, Server,pajisje tjera) por në vitin 2014 tërësisht kemi shfrytëzuar sistemin aktual në përdorim.

### 4.8.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NjIF-K

Në vitin 2015 stafi i NjIF ka marrë pjesë në seminare, trajnime, konferenca dhe kurse, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit. Kjo ishte njëheritpërbushje e objektivave dhe akvitetëve të planit strategjik të NjIF-K.

Si rezultat i zbatimit të një politike të vazhdueshme të trajnimit, si dhe në përbushje të objektivit të saj strategjikë "Trajnime të specializuara analitike dhe hetuese për zyrtarët e NjIF-K" kanë plotësuar në mënyrë të kënaqshme përbushjen e këtij objektivit, ku të gjithë zyrtarët e NjIF-K kanë marrë pjesë në aktivitete trajnuese gjatë vitit 2015.

Ngritjes së vazhdueshme profesionale të stafit të Njesisë i është kushtuar rëndësi e veçantëedhe gjatë këtij viti raportues, që për fokus ka pasur ngritjen e aftësive për analizafinanciare në lidhje me dyshimet potenciale të shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë. Kjo ngritje në aspektin profesional bëhet përmes pjesëmarrjes së stafit të NjIF-K në trajnime dhe seminare të ndryshme, ku kryesisht këto trajnime, zyrtarët nga NjIF i kanë vijuar së bashku me zyrtarët e tjerë nga institucione tjera të zbatimit të ligjit në vendin tonë.

Gjashtëmbëdhjetë trajnime, pesë seminare, katër konferenca dhe tri punëtori kanë përbërë aktivitet e ndjekura nga stafi i NjIF-K dhe të përfunduara me sukses gjatë vitit 2015.



- **Grupet Punuese të Egmont Group Berlin, Gjermani, 27-28 Janar 2015**

*Pavarësisht se NjIF-K nuk është anëtare e Grupit Egmont, ajo është ftuar disa here në takimet e kësaj organizate në të cilat zyrtarët e NjIF-K kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar në trajnimet e organizuara gjatë ditëve të takimit.*

- **Program i Specializuar trajnimi për Prokurimin Publik te Kosovës, Prishtinë,**

*Me 09 dhe 10 Mars 2015, në Prishtinë është organizuar trajnimi për Prokurimin Publik te Kosovës, organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi përfshiu përfaqësues nga NjIF-K, Prokuroria, Gjykata, Policia etj.*

- **Teknikat e Hetimeve Financiare, Prishtinë,**

*Trajnimi është organizuar nga Instituti kundër Krimeve Ekonomike dhe është mbajtur në Prishtinë me 20 deri më 24 Prill. në këtë trajnim kanë marrë pjesë një zyrtare dhe një ligjërues i NjIF-K.*

- **Punëtori për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Sirakuza, Itali, 27-30 Prill 2015**

*Për të siguruar që zyrtarët e saj janë në rrjedha me zhvillimet e reja globale, konkretisht me Rekomandimin 1 të FATF, NjIF-K ka deleguar një zyrtar për të marrë pjesë në punëtorinë "Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të PP/FT" i mbajtur nga data 27 deri më 30 Prill 2015, në Sirakuza të Italisë i cili ishte organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në bashkëpunim me Istituto Superiore Internazionale di Scienze Criminali (ISIS).*

- **Tryezë e rrumbullakët që trajton aspektet ligjore të hetimit të korrupsionit të nivelit të lartë, organizuar nga OSBE, 29-30 Prill 2015, Prishtinë**

*Tryeza dyditore që trajton aspektet ligjore të hetimit të korrupsionit të nivelit të lartë është organizuar nga Misioni i OSBE më datën 29 dhe 30 prill në Prishtinë. Qëllimi i kësaj tryeze të rrumbullakët ishte që trajtojë zbrazëirat ligjore dhe mospërputhjet ndërmjet standardeve të Bashkimit Evropian, ligjeve të Kosovës dhe akteve nënligjore, gjë që u diskutua ndërmjet akterëve përkatës. Përveç dy zyrtarëve, NjIF-K ishte i përfaqësuar edhe me një ligjërues në këtë tryezë.*

- **Seminari për hetimin e krimit financiar, sekuestrimin/konfiskimin e pasurisë, hetimin e mashtrimit me tatime dhe shpërlarjen e parave, organizuar nga OSBE, 5-7 Maj, Bogë**

*Seminar treditor për hetimin e krimit financiar, sekuestrimin/konfiskimin e pasurisë, hetimin e mashtrimit me tatime dhe shpërlarjen e parave është organizuar nga OSBE më 5 deri 7 maj në Bogë të Pejës. Kjo ngjarje mbledhi përfaqësues nga Policia e Kosovës, Prokuroria Speciale, Njësia e Inteligjencës Financiare, Administrata Tatimore, Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, Koordinatori Nacional kundër Krimeve Ekonomike, aty ishte edhe kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës, si dhe dy ekspertë ndërkombëtar që punojnë në këtë fushë.*

- **Financimi i Terrorizmit, ICITAP, 11-15 Maj 2015, Prishtinë**

*Ambasada Amerikane në Prishtinë përkatësisht ICITAP, nga data 11 deri më 15 maj në Prishtinë kanë organizuar trajnimin “Financimi i Terrorizmit” në të cilin ishin të angazhuar ekspertët nga Byroja Federale e Hetimeve-FBI. Dy zyrtarë nga NjIF-K kanë marrë pjesë në këtë trajnim.*

- **Shpërlarja e Parave dhe Financimi i Terrorizmit**

*Gjatë muajit Maj 2015, zyrtarë të NjIF-K kanë ligjëruar në trajnimin me temë “pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit” të organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ku kanë marrë pjesë Gjyqtarë dhe Prokurorë. Temat e shtjelluara në këtë trajnim ishin: Obligimet e institucioneve financiare në luftimin e pastrimit të parave, Roli dhe mandati i Njësia për inteligjencë financiare, Vepra penale e shpërlarjes së parave dhe Sanksionet, Veprat e tjera penale që ndërlidhen me shpërlarjen e parave.*

- **Trajnim përkitazi me rolin e analizave operative dhe inteligjencës kriminale në luftimin e korrupsionit, organizuar nga OSBE, 19-21 Maj 2015, Pejë**

*Si pjesë e aktivitetit të 4 të projektit të Misionit të OSBE, është mbajtur trajnim treditor përkitazi me rolin e analizave operative dhe inteligjencës kriminale në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë nga data 19 deri 21 maj në Pejë.*


- **Financimi i Terrorizmit, ICITAP - MUP Croatia, 8-12 Qershor 2015, Zagreb, Kroaci**

*Në Qershor 2015, një zyrtarë i NjIF-K ka marrë pjesë në trajnimin me titull “Financimi i Terrorizmit”, trajnim ky i mbajtur në Zagreb të Kroacisë dhe i organizuar nga ICITAP (Ambasada e SHBA) dhe MUP Croatia.*

*Viteve të fundit është duke i kushtuar rëndësi e veçantë aspektit të financimit të terrorizmit, kjo duke marrë parasysh edhe ngjarjet globale përkitazi me rastet në rritje të terrorizmit. Në lidhje me këtë fushë ka pasur shumë pak trajnime të veçanta në aspekt ndërkombëtar për financim të terrorizmit andaj pritjet nga ky trajnim dhe njohurit e fituara do të ngritin edhe më tepër profesionalizmin e zyrtarit të angazhuar nga NjIF-K për t’u marrë me rastet e dyshimta të financimit të terrorizmit.*

- **Kontabiliteti bazë dhe ai forenzik për hetime efikase dhe efektive të krimeve financiare, OSBE, Prishtinë**

*Misioni i OSBE në Kosovë me qëllim të rritjes së kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit, në kuadër të këtij projektit të saj për luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, ka organizuar një trajnim dyditor për kontabilitetin bazë dhe atë forenzik për hetime efektive dhe efikase të krimet financiar, nga data 10 deri 12 qershor në Prishtinë.*



- **AFCOS Seminar - European Anti Fraud Office, OLAF- European Commission, Beograd, Serbia, 17-19 Qershor 2015**

*Gjithashtu në muajin Qershor një zyrtare e NjIF-K ka marrë pjesë në Seminarin AFCOS Seminar - European Anti Fraud Office të mbajtur në Beograd, Serbia.*

- **Qasja e bazuar në rrezik në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, organizuar nga IMF dhe JVI, Viena, Austri**

*Fondi Monetar Ndërkombëtar në bashkëpunim me Joint Vienna Institute (JVI) kanë organizuar një kurs njëjavor të titulluar " Qasja e Bazuar në risk në luftën kundër pastrimit të parave Financimit të Terrorizmit me fokus në inspektimin e sektorit financiar, i cili kurs është mbajtur në Vienë, Austri gjatë muajit gusht 24-28, 2015.*

- **Procedurat e prokurimit dhe e-prokurimi, privatizimi, procedurat e likuidimit dhe roli i forenzikës së TI-së në hetime, organizuar nga OSBE, Prishtinë**

*Nga 7 deri më 11 shtator, OSBE ka ofruar trajnim mbi procedurat e prokurimit dhe e-prokurimin, privatizimin, procedurat e likuidimit dhe rolin e forenzikës së TI-së në hetime, për 12 pjesëmarrës nga institucionet e zbatimit të ligjit në vend, si dhe dy përfaqësues nga Njësia e Inteligjencës Financiare në Prishtinë.*

- **Projekti për targetimin e të ardhurave përmes krimit kibernetikë, Bukuresht, Rumani, 14-15 Shtator 2015**

*Njësia për Inteligjencë Financiare nga data 14 deri 15 Shtator 2015 ka marrë pjesë në punëtorinë për hartimin e projekt mbi bashkëpunimi për krimin kibernetikë në kuadër të Instrumentit të Para- Anëtarësimit ( IPA ).Shtetet që pritet të përfitojnë nga ky projekt janë: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Turqia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina.*

- **DIILS Seminari Aspektet Ligjore te Luftimit te Korrupsionit, Ambasada Amerikane/Instituti i Mbrojtjes për Studime të Drejtës Ndërkombëtare, 14-17 Shtator 2015, Prishtinë**

*Nga data 14 deri më 17 Shtator nën organizimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, përkatësisht Institutit të Mbrojtjes për Studime të Drejtës Ndërkombëtare, është organizuar trajnimi me titull "Aspektet ligjore të luftimit të korrupsionit", pjesëmarrës në të cilin kanë qenë përfaqësues nga institucionet relevante të kësaj fushe në vend. Ekspert me përvojë nga SHBA kanë ligjërue në këtë trajnim.*

- **Hetimet e avancuara të narkotikëve, Ambasada Amerikane/ICITAP, 22-25 Shtator 2015, Prishtinë**

*Tre zyrtarë nga NjIF-K kanë marrë pjesë në trajnimin për "hetimet e avancuara të narkotikëve" si vepër e ndërlidhur e pastrimit të parave, i organizuar nga Ambasada Amerikane, përkatësisht ICITAP.*



- **Seminar për bashkëpunimin me autoritetet dhe forcat policore ndërkombëtare në hetimin e veprave penale me elemente të korrupsionit , OSBE, Shtator 2015**

*Nga 29 deri më 30 shtator, Misioni i OSBE organizoi seminar për bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare dhe shërbimet policore për hetimin e veprave penale me elemente korrupsioni. Qëllimi i seminarit ishte që të ofrojë forum për diskutimin e sfidave në fushat e bashkëpunimit, ndihmës juridike dhe këmbimit të informatave në nivel ndërkombëtar, por edhe për hetimet e përbashkëta, inteligjencën financiare dhe shpëlarjen e parave. Dy folës kryesorë nga Sllovenia dhe Kroacia prezantuan praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rastet e studimit gjatë seminarit, i cili gjithashtu u ndoq nga përfaqësues të institucioneve e agjencive vendore përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, si dhe përfaqësues të ambasadës Italiane, Franceze dhe Zvicerane.*

- **Instrumentet ndërkombëtare në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së krijuar në mënyrë të kundërligjshme, organizuar nga GIZ, Prevallë, 19-20 Tetor 2015**


*Organizuar nga GIZ Gjermani, në muajin Tetor 2015 në Prevallë, Kosovë është mbajtur seminari dyditor me në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Në mesin e pjesëmarrësve nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, ishin edhe dy zyrtarë të NjIF-K*

- **Konferenca rajonale për luftimin e korrupsionit, OSBE, Nëntor 2015**

*Më 4 dhe 5 nëntor, Misioni i OSBE në Kosovë organizoi konferencë rajonale për luftimin e korrupsionit. Përfaqësuesit nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja e Hercegovina si dhe Kroacia, prezantuan gjendjen e tyre dhe sfidat përkatëse në konferencë.*

- **Trajnim i specializuar mbi Prokurimin Publik ne Kosove organizuar nga IGJK, Bogë Rugovë, Nëntor 2015**

*Sesioni i dytë i trajnimit të specializuar për prokurimin publik në vend është mbajtur me 20 dhe 21 Nëntor 2015, në Bogë, Pejë, organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi përfshiu përfaqësues nga NjIF-K, Prokuroria, Gjykata, Policia etj.*





## 5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

### 5.1. *Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor*

Përkushtimi i NjIF-K në ngritjen e vazhdueshme të bashkëpunimit ndër-institucional dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga dokumentet strategjike nacionale, është përcjell edhe gjatë vitit 2015, për të cilën Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2015 thekson se “Plani i veprimit për vlerësimin e riskut kombëtar për shpëlarjen e parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në pjesën më të madhe është implementuar me kohë”. Gjithashtu mbetet që në të ardhmen të avancohet edhe më tutje bashkëpunimi në mes të Njesisë për Inteligjencë Financiare dhe organeve kyçe në zinxhirin kundër pastrimit të parave.

Krijimi i mekanizmave të përbashkët për shkëmbim të informacioneve mes agjencioneve të cilat kanë përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar, tashmë është një rekomandim i përmbushur dhe implementuar nga agjensionet kompetente vendore.

Këtij bashkëpunimi dhe krijimit të mekanizmave ndër-institucional i ka paraprirë nënshkrimi i një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse bashkëpunimi për shkëmbimin e informatave, vlerësimin e riskut dhe koordinim në mes të institucioneve dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit për luftimin dhe parandalimin e krimeve ekonomike dhe financiare. Nënshkrues të kësaj marrëveshjeje ishin udhëheqësit e pesë institucioneve vendore: Prokuroria e Shtetit, Policia, NjIF-K, Dogana dhe ATK. Gjithashtu, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik përveç që shërben si një mekanizëm kyç i bashkërendimit dhe koordinimit shtetëror në fushën e luftimit të krimit ekonomik, përfshirë PP/FT, krijimi i saj është bërë edhe me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të krimeve, sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimeve materiale që burojnë nga krimi.

Në pajtim me legjisllacionin në fuqi, rekomandimet dhe direktivat ndërkombëtare, në mënyrë që të kryejnë detyrat e saj NjIF-K duhet t'i lejohet qasje në kohë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të të dhënave financiare, administrative dhe të sigurta të informatave dhe dokumentacionit e cila do të kontribuojnë në analizën më të shpejtë të RTD-ve. Rrjedhimisht, NjIF-K ka qasje të tërthortë dhe drejtpërdrejt në disa nga të dhënat e institucioneve vendore, përderisa të dhënat tjera mbledhen edhe me anë të një kërkesë me shkrim.

Në këtë drejtim, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit ndër-institucional në zbulimin dhe parandalimin e veprave penale që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit si dhe veprat e ndërlidhura penale si korrupsioni, krimi i organizuar dhe veprat tjera penale, NjIF-K viteve të fundit ka nisur një projekt për krijimin e linjave të drejtpërdrejta të komunikimit me agjensionet e zbatimit të ligjit në vend dhe të tjera për shkëmbimin e informacionit dhe krijimit të qasjeve të drejtpërdrejta ose tërthorta në sistemet e tyre. Institucionet janë siguruar që shkëmbimi i tillë i informacioneve të bëhet përmes një sistemi të sigurt të komunikimit duke përdorur kanale të sigurta për shkëmbimin e të dhënave. Një qasje e tillë e lejon shkëmbimin e shpejtë të informacionit të caktuar e cila e rrit efikasitetin e punës në kuadër të kompetencave ligjore të institucioneve kompetente.



Shkëmbimi vendor i informatave në vitin 2015 ka pësuar një rënie të vogël krahasuar me vitin paraprak, megjithëse ka takime më të shpeshta në mes të zyrtarëve të NjIF-K dhe autoriteteve hetuese në lidhje me hetimet e përbashkëta të rasteve të ndërlidhura me PP/FT, e cila tregon për një ngritje të bashkëpunimit me institucionet të zbatimit të ligjit, rritjen e besueshmërisë dhe rëndësinë e informacioneve të Njësisë për Inteligjencë Financiare dhe rritjes së profesionalizmit të këtij institucioni. Shkëmbimi më i theksuar i informacioneve vazhdon të mbetet me Policinë e Kosovës, Doganën dhe ATK, përderisa këtë vit ka filluar të ketë ngritje edhe bashkëpunimi me AKI sidomos me dyshimet për financim të terrorizmit dhe terrorizmin si dhe krimin e organizuar.

Përveç shkëmbimit të informatave, Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2015 thekson gjithashtu se “ka pasur një rritje të numrit të rasteve kundër shpëlarjes së parave që i janë përcjelle prokurorisë “

Institucionet parashtruese të kërkesës	2011	2012	2013	2014	2015
Policia e Kosovës	21	28	57	91	52
AKI	0	5	14	23	19
EULEX	16	15	8	11	7
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	4	4	1	6	3
Prokuroria e Shtetit	0	0	5	6	3
Administrata Tatimore e Kosovës	1	2	20	7	2
Dogana e Kosovës	18	44	61	25	15
ILECUs	0	2	15	6	6
Tjera	4	3	2	2	3
<b>Gjithsej</b>	<b>64</b>	<b>103</b>	<b>183</b>	<b>177</b>	<b>110</b>

Tabela nr.25 - Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NjIF-K 2011-2015

#### 5.1.1. Bashkëpunimi me Prokurorin e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale

NjIF-K mbetet e përkushtuar të bashkëpunojë dhe bashkërendojë aktivitetet e përbashkëta me Prokurorinë e Shtetit në përgjithësi dhe Prokurorinë Speciale në veçanti, e cila ka juridiksion ekskluziv në lidhje me ndjekjen e veprave penale të PP. Ky vit raportues tregon për një ngritje efektive të bashkëpunimit dhe komunikimit mes dy institucioneve, duke marrë pjesë bashkërisht në task forca të krijuara për raste të veçanta dhe duke kontribuar në drejtim të zbulimit dhe parandalimit të veprave penale sidomos të PP/FT dhe krimeve financiare në përgjithësi.

Për më tepër, NjIF-K është pjesë e grupit për zbulimin dhe shënjestrimin e rasteve të krimeve të rënda, grup ky i udhëhequr nga PSRK dhe me një pjesëmarrje edhe nga institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Numri i kërkesave për informata për shkëmbim të informacioneve me Prokurorinë mbetet në shifra të përafërta me vitet e kaluara. Rreth 5% e numrit të gjithëmbarsuem të kërkesave për shkëmbim të informatave drejtuar NjIF-K, kanë ardhur nga Prokuroria e vendit.



Ndër të tjera, raporti për Kosovën i BE thekson se departamentet e Prokurorisë Speciale të Kosovës duhet të forcohen në mënyrë që të trajtojnë më shumë raste kundër shpërlarjes së parasë. Ky raport gjithashtu thekson se ka pasur një rritje të numrit të rasteve kundër shpërlarjes së parave që i janë përcjelle prokurorisë. Megjithatë, deri më tash janë dhënë vetëm disa dënime.

#### 5.1.2. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës

Bashkëpunimi për çështje operacionale dhe shkëmbim të informacioneve mbetet përherë më i larti në mes të NjIF-K dhe Policisë së Kosovës. Rezultat i këtij bashkëpunimi ishte edhe nënshkrimi mes dy institucioneve të një Memorandumi të Mirëkuptimit, marrëveshje kjo e lidhur vitet e fundit qëllimi i së cilës është që të shtohet bashkëpunimi dhe koordinimi mbi shkëmbimin e informatave në mes të Palëve, në lidhje me parandalimin e shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të tjera penale që ndërlidhen me shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit. Memorandumi i mirëkuptimit ka përcaktuar edhe procedurat e shkëmbimit të informatave në mënyrë elektronike përmes së cilës komunikimi elektronik në mes të Palëve do të realizohet nëpërmjet sistemit elektronik të NjIF-K të quajtur goAML, komunikim ky i cili në masë të madhe ka ngritur shpejtësinë dhe cilësinë e shkëmbimit të informatave.

Në pesë vitet e fundit, të dhënat tregojnë për një shifër prej 160 raporte të inteligjencës financiare të përcjella nga NjIF-K në drejtim të njësisë përkatëse të Policisë së Kosovës, shifër kjo e cila përfshinë rreth 49% e numrit të gjithëmbarsëm të raporteve të shpërndara në këto pesë vitet e fundit. Rezultatet e analizave të NjIF-K kanë shërbyer si bazë për fillimin e hetimeve të cilat kanë qenë shumë të rëndësishme për rezultatet vijuese të hetimeve dhe ndjekjeve penale, për të cilat të dhënat tregojnë për një numër të konsiderueshëm të personave të arrestuar nën dyshimin e përfshirjes në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo veprave tjera të ndërlidhura.

Krijimi i qasjes në të dhënat e PK ka dhënë kontribut jashtëzakonisht shumë në drejtim të përshejtimit dhe ngritjes së cilësisë së analizave të NjIF-K.

Përveç raporteve të rrjedhura nga NjIF-K, këto vite tregojnë edhe për një bashkëpunim të shkëlqyer në mes dy institucioneve sa i përket shkëmbimit të informacioneve, që rezultatet nga të dhënat statistikore tregojnë për një numër prej 249 kërkesave për informata të parashtruara nga PK për NjIF-K. Kthimi i përgjigjeve në kohë ka qenë një nga synimet e NjIF-K në funksion të zbulimit të rasteve penale, verifikimit dhe gjurmimit të pasurisë apo edhe hetimeve për çështjet e terrorizmit dhe krimit të organizuar.

#### 5.1.3. Bashkëpunimi me Doganën dhe Administratën Tatimore

NjIF-K ka një bashkëpunim të ndërtuar vite më parë me Doganën dhe ATK, bashkëpunim ky i kurorëzuar edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të institucioneve, të cilat marrëveshje ndër të tjera përcaktojnë dhe rregullojnë: bashkëpunimin e përgjithshëm dhe avancimin e luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ruajtjen e ligjshmërinë dhe cilësinë e kërkesave të shkëmbyera mes institucioneve, emërimine pikave të



kontaktit, procedurat dhe modalitetet e shkëmbimit të informacioneve përmes formatit elektronik, mbrojtja e të dhënave dhe mbajtja e konfidencialitetit, përkufizimi se informacionet e këmbyerat nuk mund të përdoren për qëllime tjera përveç në bazë të asaj që është arritur pajtimi, informacionet duhet të përdoren vetëm për qëllime të inteligjencës, nuk bëhet shpërndarje e mëtejme e informacioneve të marra nga palët përkatëse pa miratim paraprak.

Viteve të fundit është vlerësuar se ka progres në masat parandaluese të ndërmarra nga Dogana për deklarim të mjeteve monetare në pikat e kalimit kufitar.

Gjatë vitit 2015 është rritur numri i raporteve të inteligjencës të shpërndara në ATK dhe Doganë përkitazi me dyshimet për evazion fiskal ose kontrabandë.

Informatat kthyese të transmetuara në mënyrë sistematike nga ATK kanë treguar se nga gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) informata kthyese, në katërmëdhjetë (14) prej tyre ka rezultuar me gjetjet se kishte evazion fiskal dhe nga ATK është konstatuar se subjektet e hetuara janë ngarkuar me tatimin që është dashur ta deklarojnë ose paguajnë në periudhat e kaluara.

#### 5.1.4. Bashkëpunimi me AKI

Viti 2015 ka shënuar progres në bashkëpunimin për çështje operative dhe tjera në mes të NjIF-K dhe AKI me fokus të veçantë në shkëmbimin e informatave për terrorizëm dhe financimin e terrorizmit, krimin e organizuar etj. Përveç shkëmbimit të informacionit, NjIF-K ka shpërndarë raporte të inteligjencës për çështjet të cilat bien nën mandatin e AKI.

Gjatë vitit 2015, AKI është autoriteti i dytë pas Policisë së Kosovës që ka numrin më të madh të parashtrimit të kërkesave për informacion drejtuar NjIF-K, e cila përfshin rreth 17% të numrit të përgjithshëm të kërkesave për informata.

Ajo çfarë e karakterizon koordinimin në mes institucioneve tona janë edhe takimet e shpeshta të mbajtura mes zyrtarëve tonë për rastet në proces që lidhen sidomos për terrorizmin dhe financimin e tij.

#### 5.1.5. Bashkëpunimi me EULEX

EULEX dhe NjIF-K kanë vazhduar bashkëpunim e mirë të ndërtuar në vitet e kaluara, pavarësisht se që nga fundi i vitit 2014 prezenca fizike e stafit të EULEX nuk ishte në strukturën e NjIF-K (për shkak të shkurtimeve të stafit dhe përfundimit të misionit të tyre në EULEX përkatësisht në NjIF-K) ndihma dhe mbështetja e këtij misioni ka vazhduar të jap kontributin e tij për autoritetet vendore përfshirë këtu edhe mbështetjen për NjIF-K.

Përveç shkëmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit operacional, bashkëpunimi në mes institucioneve gjegjëse është përqendruar edhe në ndihmën dhe mbështetjen teknike që misioni i EULEX i ka dhënë NjIF-K, duke dhuruar si donacion dy automjete që do të shërbejnë për punë operative të NjIF-K, si dhe pajisje të teknologjisë informative.



#### 5.1.6. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale

Implementimii Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, është bërë në mënyrë të suksesshme nga Njësia duke tejkuluar indikatorët kyç të performancës të paraqitur në atë plan të veprimit. Detyrat e punës për secilin aktivitet janë shpërndarë tek zyrtarët kompetentë të njësisë, dhe raportimi bëhet në baza të rregullta periodike. Implementimin e objektivave dhe aktivitetëve të Planit të Veprimit të njësisë e monitoron anëtari i sekretariatit të Strategjisë, përderisa raportin e përmbushjes së atyre aktivitetëve e miraton Grupi i Përhershëm Qeveritar.

Kontributi i NjIF-K ka vazhduar në implementimin dhe rishikimin edhe strategjive kombëtare duke qenë pjesëmarrëse aktive në:

- Strategjinë Kombëtare kundër krimit të organizuar dhe
- Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit

#### 5.1.7. Memorandumet e Mirëkuptimit

Një pjesë e madhe e punës së NjIF-K zhvillohet në kontekstin e bashkëpunimit me autoritetet vendore. Rëndësia e mbajtjes së raporteve e mira të punës me një rreth të gjerë akterësh publik e privat është e domosdoshme për shkak të kombinimit të veçantë të funksioneve që kryen NjIF-K, përkatësisht mbledhjen e inteligjencës dhe analizat, koordinimin dhe bashkëpunimin me organet hetimore, trajnimin, mbikëqyrjen e pajtueshmërisë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. NjIF-K ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me institucionet nacionale si në vijim:

Institucioni	Data e Nënshkrimit
Agjencia Kadastrale	07/04/2009
Agjencia Anti-Korrupsion	21/04/2009
Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës	29/05/2009
Administrata Tatimore e Kosovës	17/07/2011
Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhjen me OJQ	16/12/2011
Agjencia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara apo Konfiskuara	01/01/2012
Doganat e Kosovës	12/03/2012
Policia e Kosovës	19/02/2013
Banka Qendrore e Kosovës	11/06/2013
MM për themelimin e Koordinatorit Nacional	2014
Agjencia për Regjistrim Civil	10/11/2014
Marrëveshje Bashkëpunimi për shkëmbim të informatave, vlerësim të riskut dhe koordinim në mes institucioneve dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit	Dhjetor 2014
Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Institucioneve dhe Agjencive për Zbatimin e Ligjit për krijimin e Komitetit Koordinues për TIK	Tetor 2015

*Tabela nr.26 – MM e nënshkruara me autoritetet vendore*

Qëllimi i nënshkrimit të këtyre MM është që të përdorë resurset në interes të përbashkët, të përcaktoj procedurat e shkëmbimit të informatave dhe të fuqizojë bashkëpunimin vendor në mënyrë të vazhdueshme.



## 5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

### 5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

NjIF ka autoritet, qoftë spontanisht ose sipas kërkesës, të ndajë informacion me homologët e tij jashtë vendit në përputhje me paragrafin (1.7) të nenit 14 dhe të paragrafit (1a) të nenit 15 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit.

Me qëllim të krijimit të procedurave për shkëmbimin e informacionit, NjIF-Kka lidhur marrëveshjetë ndryshme bashkëpunimi me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e NjIF-K dhe vetëm për qëllime të luftimit të pastrimit të parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

Përveç kësaj, paragrafi (1a) i nenit 15 të Ligjit për PPP/LFT i jep kompetenca NjIF-K të shkëmbejë, në nivel vendor dhe ndërkombëtar, tërë informacionin që mund të qaset ose të merret drejtpërdrejt apo tërthorazi nga NjIF-K.


Të dhënat tregojnë për një numër gjithnjë e në rritje të shkëmbimit dhe ndarjes spontane të informacionit me NjIF homologe. Kjo rritje mund të rezultojë edhe me pjesëmarrjen e NjIF-K në takime dhe tryeza të përbashkëta ndërkombëtare.

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2011	2012	2013	2014	2015
<b>KËRKESAT E PRANUARA DHE SHPËRNDARA</b>					
Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NjIF-K	10	10	7	19	18
Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NjIF-K	12	13	6	20	18
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NjIF-K	0	0	0	0	0
Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave nga NjIF-ët e huaj	49	33	26	29	23
<b>Ndarja spontane e informacioneve</b>					
Informacioni Spontan i pranuar nga NjIF-K	0	0	2	1	1
Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K	//	//	3	6	8

Tabela nr.27 – Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2011-2015

Raporti në mes të numrit të kërkesave të NjIF të huaja të dërguara në NjIF-K dhe kërkesave të NjIF-K drejtuar për NjIF tjera homologe në vitin 2015 është përafërsisht i ngjashëm, ndërsa një vit më parë numri i kërkesave të NjIF Kosovë drejtuar NjIF ndërkombëtare ishte më i lartë se sa numri i kërkesave ndërkombëtare të pranuar.





Grafiku nr.20 – Kërkesat ndërkombëtare drejtuar NjIF-K (IRI) dhe kërkesat e NjIF-K për NjIF ndërkombëtare (ORI) 2014-2015

#### 5.2.1.1. Kërkesat e Pranuara dhe Shpërndara për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar

Kërkesat ndërkombëtare për shkëmbim të informacioneve të pranuar nga NjIF-K në vitin 2015 (18) ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2014 (19). Këtyre kërkesave NjIF-K u është përgjigjur në mënyrë efikase dhe në kohë sa më të shkurt të mundshme. Rreth 50% e kërkesave janë bërë nga vendet e rajonit, përderisa 39% nga FIU e bashkimit europian, kurse rreth 11% nga venet tjera.

Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NjIF-K	2015
FIU Shqipëri	3
FIU Gana	1
FIU Hungari	2
FIU Maqedoni	5
FIU Sllovenia	2
FIU Zvicër	2
FIU Turqi	1
FIU Holandë	1
Agjensionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit	1
<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>

Tabela nr.28 – Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NjIF-K 2015

Numri i përgjigjeve të kthyer nga NJIF-ëve ndërkombëtare siç mund të vërehet është i përafërt me kërkesat e parashtruara, gjë që tregon se NjIF-K nuk ka refuzuar ndonjë kërkesë për t'u përgjigjur. Duke krahasuar të dhënat në pesë vitet e fundit vërehet për një ngritje të lehtë të



numrit të kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar, duke bërë që të zgjerohet edhe kategoria e vendeve me të cilat janë shkëmbyer informacione. Kjo është rezultat edhe i pjesëmarrjes gjithnjë e në rritje të NJIF-K në takime dhe konferenca ndërkombëtare.

Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K	2015
FIU Shqipëri	3
FIU Gana	1
FIU Holandë	1
FIU Hungari	2
FIU Maqedoni	4
FIU Sllovenia	2
FIU Zvicër	1
FIU Turqi	1
Agjensionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit	3
<b>Gjithsej</b>	<b>18</b>

*Tabela nr.29 – Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K 2015*

Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF	2011	2012	2013	2014	2015
FIU Maqedonia	6	5	1	3	4
FIU Mali i Zi	2	6	5	3	-
FIU Kroacia	-	1	-	1	-
FIU Holanda	-	1	-	-	1
FIU Shqipëri	2	-	-	1	3
FIU Bosnja dhe Hercegovina	1	-	-	-	-
FIU Gjermani	1	-	-	-	-
FIU Austri	-	-	-	1	-
FIU Bulgari	-	-	-	2	-
FIU Slloveni	-	-	-	2	2
FIU Zvicër	-	-	-	2	1
FIU Hungari	-	-	-	-	2
FIU Turqi	-	-	-	-	1
FIU Gaana	-	-	-	-	1
Agjensionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit	-	-	-	5	3
<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>20</b>	<b>18</b>

*Tabela nr.30 – Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K 2011-2015*





5.2.1.2. *Kërkesat e NjIF-K drejtuar FIU ndërkombëtare për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar*

Krahas mbledhjes dhe përpunimit të informacionit të pranuar nga autoritetet vendore, gjatë analizave të saj operacionale NjIF-K mund të has në raste specifike që kërkohet edhe informacioni nga vende tjera, për të cilat NjIF-K mund t'ju drejtohet me kërkesë për informacion varësisht nga rasti. Falë bashkëpunimit të ndërtuar me NjIF ndërkombëtare, ky informacion në shumicën e rasteve është i qasshëm nga ana e NjIF-K.

Ky vit i raportimit tregon për një rënie prej rreth 32% krahasuar me vitin 2014. Të dhënat e prezantuara më poshtë tregojnë se NjIF-K bashkëpunimin e saj e shtrin edhe përtej vendeve të regjionit.

<b>Kërkesat e NjIF-K për FIU tjera homologe</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
FIU Austria	1	0
FIU Bosnja dhe Hercegovina	1	0
FIU Britani e Madhe	0	1
FIU Ghana	0	1
FIU Gjermani	4	2
FIU Greqi	0	1
FIU Holandë	1	0
FIU Itali	3	1
FIU Mali i Zi	0	3
FIU Maqedoni	1	0
FIU Qipro	1	1
FIU Shqipëri	6	3
FIU Suedi	1	0
FIU Turqi	4	3
FIU Ukrainë	2	0
FIU Zvicër	0	1
<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>17</b>


*Tabela nr.31 – Kërkesat e NjIF-K drejtuar FIU tjera homologe 2015*



### 5.2.1.3. Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit

NjIF-K i kushton vëmendje të veçantë kërkesave të huaja dhe është duke bërë përpjekje për ekzekutimin në mënyrë efikase të kërkesave ndërkombëtare në kohë të duhur dhe pa vonesa të paarsyeshme.

Afatet kohore për përfundimin e ndonjë kërkesë zakonisht varen nga përmbajtja e kërkesave të veçanta. Në këtë kontekst, koha mesatare për kthimin e përgjigjeve në vitin 2015, ka qenë 23 ditë, i cili numër është më i vogli në pesë vitet e fundit.




Grafiku Nr.21 - Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të huaja

### 5.2.1.4. Ndarja Spontane e Informacionit me FIU Ndërkombëtare

NjIF-K ofron një gamë të gjerë të mundshme të bashkëpunimit ndërkombëtar për homologët e tyre të huaj qoftë edhe përmes ndarjes spontane të informacioneve. Informacionin i shkëmbyer në mes homologëve përdoret vetëm në mënyrë të autorizuar dhe për qëllime inteligjence.

Paragrafi (1.7) i nenit 14 të Ligjit për PPP/LFT fuqizon NjIF-in që, spontanisht, të këmbëjë informata me ndonjë agjenci të huaj që kryen funksione të ngjashme, si dhe i nënshtrohet detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit, pa marrë parasysh natyrën e agjencisë.

Gjatë vitit 2015, NjIF-K ka shpërndarë gjithsej 8 raporte spontane të inteligjencës për homologët e huaj ndërkombëtarë të cilat raporte kanë shkuar për analizim të mëtutjeshëm tek FIU e Shqipërisë, Britanisës së Madhe, Maqedonisë, Malitë Zi dhe Suedisë. Në tri vitet e fundit janë shpërndarë gjithsej 17 raporte spontane, përderisa janë pranuar 4 sosh.



Grafiku nr.22 –Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K 2013-2015

Të dhënat më të detajuara për tri vitet e fundit janë paraqitur në tabelën në vijim:

Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K	2013	2014	2015
FIU Shqipëri	-	-	3
FIU Britani e Madhe	-	-	1
FIU Bjellorusi	-	1	-
FIU Lituanit	-	1	-
FIU Poloni	-	1	-
FIU Maqedoni	1	1	2
FIU Qipro	-	1	-
FIU Gjermani	-	1	-
FIU Luksemburg	1	-	-
FIU Mali i Zi	1	-	1
FIU Suedi	-	-	1
<b>Gjithsej</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>8</b>

Tabela nr.32 –Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K 2013-2015

### 5.2.2. Bashkëpunimi regional

Në Mars të vitit 2015, një delegacion nga FIU Maqedonia i kryesuar nga Drejtori i saj, kanë qëndruar për një vizitë zyrtare në NjIF-K. Qëllim i kësaj vizite ishte diskutimi mes dy delegacioneve për çështjet që janë me interes të përbashkët në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, shkëmbimit të informatave në mes dy njësive, rreziqet dhe trendët e reja globale me të cilat vendet tona përballen në fushën e terrorizmit, krimin të organizuar, përfshirja e NjIF-K në zhvillimet rajonale të NJIF-ve etj.

Gjatë kësaj vizite në Prishtinë, me datë 10.03.2015, është nënshkruar edhe marrëveshja e re e bashkëpunimit mes dy njësive e cila ka zëvendësuar marrëveshjen e mëparshme të vitit 2009. Ky memorandum i mirëkuptimit do të shërbejë dhe do të jetë në funksion të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në drejtim të shkëmbimit të informacionit, rritjen e rolit të tyre në kuadrin e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve në vendet respektive si dhe ndërmarrjen e takimeve periodike për të ndjekur në vijimësi bashkëpunimin institucional.

Vazhdimësia e takimeve në mes të NjIF Kosovë dhe NjIF Shqipëri ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Në Prill të këtij viti një delegacion i NjIF-K për çështje operacionale ka udhëtuar për një vizitë pune në Tiranë, ku janë pritur nga zyrtarët kompetent të DPPPP Shqipëri. Agjenda e takimit ka qenë e nivelit operacional ku janë diskutuar çështjet me rëndësi për dy institucionet, punët operacionale të përbashkëta që janë në proces.

Për më tepër, ideja për organizimin e takimeve për çështje teknike/operacionale në mes të NjIF Kosovë dhe NjIF Shqipëri, si vazhdimësi e takimeve të mëhershme në mes të dy institucioneve, është zgjeruar edhe përtej njësive tona homologe. Kështu në mes të vitit 2015, është mbajtur takimi i përbashkët i zgjeruar në mes të DPPPP Shqipëri, SHISH Shqipëri, NjIF-K dhe AKI.



Fokusi i takimit ka qenë kryesisht për çështjet e financimit të terrorizmit, radikalizmi, përfshirja e entiteteve shqiptare dhe kosovare, duke diskutuar edhe çështje konkrete. gjatë këtij takimi është diskutuar gjithashtu edhe për çështje të rëndësishme që përfshin krimin e organizuar dhe pastrimin e parave.

### 5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit

Pavarësisht se paragrafi (1.7) i nenit 14 dhe paragrafi (1a) i nenit 15 të Ligjit për PPP/PFT i lejon ligjërisht NjIF-K të ndajë informacion spontanisht ose sipas kërkesës me FIU tjera ndërkombëtare. Përtej kësaj, gjithashtu paragrafi (1.14) i nenit 14 i po të njëjtit ligj ia mundëson NjIF-K me lidh marrëveshje me një agjenci homologe të huaj e cila kryen funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e fshehtësisë, krejt kjo me qëllim të krijimit të procedurave për shkëmbimin e informacionit.

NjIF ka lidhur marrëveshje të bashkëpunimit me vendet të ndryshme të rajonit dhe më gjerë. Në vitin 2015 janë lidhur MM të reja me FIU nga Hungaria dhe Gana si dhe është ripërtërirë marrëveshja me Maqedoninë. Objektivi i NjIF-it është që të ndërtojë marrëdhënie bashkëpunimi me sa më shumë shtete sa i përket këmbimit të informacioneve që lidhen me pastrimin e parave dhe/apo financimin e terrorizmit.

Memorandumet e Mirëkuptimit me FIU ndërkombëtare			
Juridiksioni	Viti	Juridiksioni	Viti
Shqipëri (DPPPP)	2009	Republika Çeke (FAU-CR)	2012
Maqedoni (MLPD)	2009	Finlanda (FIU)	2013
Mali I Zi (APML)	2009	Polonia (GIIF)	2014
San Marino (FIA)	2009	Shqipëri (DPPPP)*	2014
Sllovenia (OMLP)	2009	Hungari (HFIU)	2015
Kroacia (AMLO)	2010	Maqedoni (FIO)*	2015
Turqia (MASAK)	2012	Gana (FIC)	2015

\*Ripërtirje

Tabela nr.33 - Memorandumet e Mirëkuptimit me NjIF ndërkombëtare




## 5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare

### 5.2.4.1. *Egmont Group*

Inicimi i procesit për anëtarësimin e NjIF-K në Egmont Group ka filluar në vitin 2013. Procedura për anëtarësimin e NjIF-K ishte përfshirë në agjendën e mbledhjes së grupeve punuese të Egmont-it fillimisht në grupin e arritshërisë e pastaj edhe në grupin ligjor të punës.

Në fund të muajit Janar është mbajtur takimi i Grupit Egmont në Berlin, Gjermani. Drejtori i NjIF-K ishte i ftuar në këtë takim. Njëra nga pikat e diskutimit në takimin e grupit Ligjor ka qenë edhe plotësimi i kushteve për anëtarësim nga ana e NjIF-K. Rekomandim i vetëm ka qenë që Kosova duhet t'i bëjë ndryshimet ligjore sa i përket financimit të terrorizmit, me qëllim që pjesa ligjore të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Kosova të vazhdojë rrugën e anëtarësimit në Egmont.

Pas këtyre vërejtjeve, NjIF-K ka përfshirë propozimet e tyre në draft ligjin që pritet të ndryshohet.



## 6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT

### 6.1. *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018*

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018, dokumente këto të politikave strategjike të miratuara një vit më parë, përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut kombëtar nga fenomenet e dëmshme të trajtuara nga kjo strategji. Krahas kësaj Strategjie Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Strategjia ishte hartuar bazuar në të gjeturat e raportit të vlerësimit të rrezikut kombëtar ku janë identifikuar gjashtë objektiva kryesore:

- i. Ngritja e vetëdijes për ndikimet në ekonominë joformale dhe krimeve financiare
- ii. Forcimin e parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mirë dhe partneritetin social
- iii. Promovimi i procedurave të inteligjencës, hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpërlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare
- iv. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve relevante
- v. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare
- vi. Zhvillimi i legjisllacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas.


Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përbën një udhërrëfyes që duhet të përcjillet në mënyrë që të përmbushen aktivitetet dhe objektivat strategjike. Ky Plan i Veprimit është rishikuar në fund të vitit 2015 për t'u plotësuar me të gjeturat nga vlerësimi sektorial i përfunduar po gjatë vitit 2015.

NjIF-K është një nga institucionet kyçe për sa i përket implementimit të kësaj Strategjie dhe Planit të veprimit, për të cilën është autoriteti përgjegjës në lidhje me përmbushjen eshtatë (7) veprimeve të përcaktuara në planin e veprimit, përderisa si institucion mbështetës ishte i përfshirë në gjithsej njëzetedy (22) aktivitete. Aktivitetet kryesore të cilat NjIF-K pritet t'i implementojë si institucion përgjegjës në periudhën 2014-2018 janë me sa vijon:

- i. Zbatimi i aktiviteteve mbikëqyrëse të pajtueshmërisë për të vlerësuar PPP/LFT duke raportuar pajtueshmërinë e subjekteve me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (aktiviteti 2.2.10).

Ky aktivitet është implementuar gjatë vitit 2015, për të cilin të dhënat tregojnë se gjatë atij viti janë ndërmarrë gjithsej 26 aktivitete të inspektimit të pajtueshmërisë

- ii. Implementimi i vlerësimeve të rrezikut specifik për degën dhe sektorin, duke u fokusuar në degët dhe sektorët më të cenusshëm për sa i përket shpërlarjes së parasë dhe financimit të



terrorizmit. Duhet të vlerësohet dhe sigurohet pajtueshmëria e tyre me Ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit (akt. 2.2.11).

Gjatë dy viteve të implementimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018, është përfunduar një Vlerësim i rrezikut të sektorit specifik në pastrim të parave dhe financim të terrorizmit për kompanitë e ndërtimit në Kosovë. Pritet që në periudhat e ardhshme të ndërmerren edhe vlerësime tjera sektoriale.

- iii. Organizimi i NjIF-K-së për të pasqyruar detyrat dhe kërkesat e reja të agjencisë të parashikuara me ligj duke u bazuar në ambientin e tij funksionues (akt. 2.3.1).
- iv. Krijimi i Procedurave Standarde të Veprimit për aktivitetet e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të NjIF-K (akt. 2.3.3).


NjIF-K ka përbushur këtë aktivitet duke miratuar PSO-në për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë.

- v. Sigurimi i anëtarësimit të NjIF-K-së në Grupin Punues Rajonal të NjIF-ve në rajon për ta rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (akt. 2.5.1).
- vi. Sigurimi i anëtarësimit të NjIF-K-së në Grupin Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare për të rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (akt. 2.5.2).

NjIF-K është në proces të përbushjes së këtij aktiviteti, për të cilin pritët që në të ardhmen të jetë anëtare e Grupit Egmont.

- vii. Sigurimi i bashkëpunimit operativ të NjIF-K-së me NjIF-të e huaja përkatëse përmes nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit për rritjen e shkëmbimit ndërkombëtar të inteligjencës financiare për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (akt. 2.5.3).

Ky aktivitet vazhdon të përbushet në mënyrë të vazhdueshme përmes nënshkrimit të MM të reja (në vitin 2015, 3 MM të nënshkruara), si dhe ngritjes së numrit të shkëmbimit ndërkombëtar të informacioneve.



## 7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

### 7.1. *Projektete financuara nga BE-ja*

Në periudhën 2013 - 2015 përmes asistencës teknike të Bashkimit Evropian për Kosovë është implementuar Projekti i BE-sëi titulluar “ Mbështetje institucioneve të Kosovës në luftimin e krimit financiar dhe ekonomik”. Projekti në fjalë është financuar nga BE-ja si dhe ishte menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë. Implementimi i projektit është bërë prej anës së kompanisë B&S Europe. Vlera totale e projektit ka qenë 1,170,000 €. Projekti ka përfunduar në Maj të vitit 2015.

Objektivii përgjithshëm i projektit ka qenë mbështetja e autoriteteve Kosovare në përfundimin e sundimit të ligjit përmes mbështetjes së mëtutjeshme të zbatimit të përgjithshëm të ligjit dhe luftimit të përgjithshëm të krimit të organizuar me fokus në krimin financiar dhe ekonomik.

Qëllimi i këtij projekti ishte përfundimi i Njesisë së Inteligjencës Financiare, Ministrisë së Financave dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit në zbatimin efektiv të kornizës së harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse ligjore dhe rregullator për luftimin e krimit financiar.

Rezultatet e projektit kanë qenë të kënaqshme. Ekipi i Projektit ka arritur të gjitha rezultatet e pritura me mbështetjen e bashkëpunëtorëve kombëtar dhe ndërkombëtar. Komentet e përfituesve dhe të partnerëve ishin të shkëlqyeshme.

Përfituesit primar të aktiviteteve të Projektit ishin Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës dhe Ministria e Financave. Përfitues indirekt ishin Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, prokurorët, gjyqtarët dhe partnerët e tjerë relevant. Përveç autoriteteve të sektorit publik që kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e krimeve financiare dhe ekonomike, si përfitues tjerë të projektit ishin edhe sektori privat dhe shoqëria civile të cilat gjithashtu kanë rol të rëndësishëm dhe janë mekanizëm i fuqishëm në drejtim të parandalimit të krimeve financiare dhe ekonomike në përgjithësi.

Projekti kishte Komitetin Drejtues të saj i cili përbëhej prej Anëtarëve që ishin përfaqësues të institucioneve vijuese: NjIF-Kosovë (Kryesues i komitetit drejtues), Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës, EULEX, Dogana e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Policia e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Zyra e BE-së në Kosovë.

Fillimisht, projekti ka pasur tri komponentë të cilët ishin përcaktuar në Termat e Referencës:

- **Komponenti 1:** Korniza gjithëpërfshirëse ligjore dhe rregullatore për luftim të krimit financiar e kompletuar dhe e harmonizuar (duke përfshirë rregullat procedurale të cilat ipërcaktojnë përgjegjësitë e entiteteve relevante publike dhe private),
- **Komponenti 2:** Përfundimi i kapaciteteve të Njesisë së Inteligjencës Financiare dhe agjencive të zbatimit të ligjit për luftimin e krimit financiar,
- **Komponenti 3:** Rritja e vetëdijessë agjencive të zbatimit të ligjit, entiteteve relevante private dhe publikut të gjerë në luftimin e krimit financiar.





Pastaj Komisioni i BE-së ka miratuar një aktivitetet shtesë në projekt si në vijim:

- Aktiviteti Shtesë 1: Të zhvillohet vlerësimi me konkludimet dhe rekomandimet për shkallën e ekonomisë joformale në Kosovë.
- Aktiviteti Shtesë 2: Dizajnimi dhe implementimi i procesit që rezulton me çertifikimin e standardizuar dhe proceset e punës së Ekspertëve kompjuterik siç kërkohet me nenin 147 të Kodit të procedurës penale.
- Aktiviteti Shtesë 3: Dizajnimi dhe implementimi i procesit që rezulton me çertifikimin e standardizuar dhe proceset e punës së Ekspertëve financiar siç kërkohet me nenin 148 të Kodit të procedurës penale.
- Aktiviteti Shtesë 4: Dizajnimi dhe zhvillimi i ndryshimeve në lidhje me strukturën dhe përbajtjen e Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit

Tri (3) komponent janë ndarë në njëzet e shtatë (27) aktivitete të veçanta secila me objektivat e veta.

Komponenti 1 përbëhet prej gjithsej gjashtë (6) aktiviteteve, nga të cilat janë implementuar me sukses të gjitha aktivitetet duke krijuar gjithsej gjashtëdhjetë e tri ( 63 ) outpute brenda kornizës së këtij komponenti, e cila është arritur falë bashkëpunimit të ekipit të projektit me mbështetjen e institucioneve kombëtare. Aktivitetet e implementuara në periudhën 2013-2015 janë si në vijim:

- *Aktiviteti 1.1: Rishikimi gjithëpërfshirës i gjendjes aktuale të punëve brenda NjIF-it (dukepërfshirë legjislacionin e aplikueshëm, PSV-të, udhëzimet e brendshme dhe projektet në proces e sipër).*
- *Aktiviteti 1.2: Draftimi i legjislacionit sekondar për të mundësuar implementimin e plotë të ligjit për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmi.*
- *Aktiviteti 1.3: Harmonizimi i legjislacionit me legjislacionet ndërkombëtare dhe Evropiane.*
- *Aktiviteti 1.4: Rishikimi dhe përcaktimi i dokumenteve procedurale për punët e brendshmetë NjIF-K.*
- *Aktiviteti 1.5: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet NjIF-K dhe institucioneve të tjera relevante kombëtare (përpilimi i MM-ve dhe të ngjashme).*
- *Aktiviteti 1.6: Inkurajimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me NjIF-e tjera gjithashtu në aspektin e anëtarësimit në Grupin Egmont*

Komponenti 2 që kishte të bënte me aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve përbëhet prej gjithsej trembëdhjetë (13) aktiviteteve, përderisa nën-komponenti 2.1 që ishte i fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve për Njësinë e Inteligjencës Financiare është përbërë prej gjithsej shtatë (7) aktiviteteve, të cila janë përmbushur suksesshëm nga ekipi i projektit ku me ndihmën e institucioneve kombëtare ka prodhuar gjithsej pesëdhjetë e nëntë (59) outpute brenda Kornizës së Komponentit 2. Aktivitetet e përmbushura janë si në vijim:

- *Aktiviteti 2.1.1: Vlerësimi i nevojave për trajnim,*
- *Aktiviteti 2.1.2: Zhvillimi i programit të trajnimit,*
- *Aktiviteti 2.1.3: Zhvillimi i një aktiviteti të plotë trajnimi për stafin e punësuar rishtazi,*
- *Aktiviteti 2.1.4: Trajnimi për praktikantët më të mira ndërkombëtare dhe ato të BE-së,*
- *Aktiviteti 2.1.5: Trajnimi për teknikat e specializuara: Analitika dhe inspektimi,*
- *Aktiviteti 2.1.6: Trajnimi i trajnerëve.*



Nën-komponenti 2.2: Ndërtimi i kapacitetit me institucionet tjera relevante:

- *Aktiviteti 2.2.1: Vlerësimi i mekanizmave ekzistues të bashkëpunimit- vlerësimi i nevojave për trajnime,*
- *Aktiviteti 2.2.2: Konsolidimi i mekanizmit të vlerësimit të rrezikut për regjimin PPP/LFT,*
- *Aktiviteti 2.2.3: Paraqitja e mjetit të monitorimit dhe metodave në mekanizmat e Bashkëpunimit,*
- *Aktiviteti 2.2.4: Trajnimi për Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore, Doganën e Kosovës, DHKRRK dhe PSRK- TFAK,*
- *Aktiviteti 2.2.5: Trajnimi për prokurorë dhe gjyqtarë (me përfshirje të zyrtarëve policor),*
- *Aktiviteti 2.2.6: Trajnimi për Odat e avokatëve, noterëve, auditorëve, shoqatave të kontabilistëve, të bankave dhe institucioneve tjera të sektorit të tretë,*
- *Aktiviteti 2.2.7: Vizitat studimore.*

Komponenti 3 që kishte si synimfushën e vetëdijesimit përbëhej prej gjithsej katër (4) aktiviteteve, rezultatete së cilës kanë nxjerrëose krijuar gjithsej gjashtëdhjetë e tri(63) outpute brenda Kornizës së këtij komponenti. Aktivitetet e implementuara gjatë tri viteve të kaluara janë si vijon:

- *Aktiviteti 3.1: Planifikimi i fushatës së vetëdijesimit dhe strategjisë për marrëdhënie me publikun,*
- *Aktiviteti 3.2: Implementimi i aktiviteteve të komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun,*
- *Aktiviteti 3.3: Krijimi ose rishikimi i Strategjisë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve tjera financiare,*
- *Aktiviteti 3.4: Implementimi i sesioneve të trajnimit – NjIF si faktor kyç në luftimin e zinxhirit të Krimet*

Komisioni i BE-së ka kryer monitorimin e projektit i cili ka marrë komente të shkëlqyeshme në bazë të vlerësimit. Monitorimi i orientuar në rezultate ka dhënë nota pozitive për performancën dhe cilësinë e Projektit. Në anën tjetër, rezultatet e misionit të monitorimit kanë demonstruar bashkëpunimin dhe koordinimin e shkëlqyeshëm ndërmjet Ekipit të Projektit, përfituesve dhe partnerëve gjatë implementimit të aktiviteteve të projektit. Ky partneritet ka siguruar një proces efikas dhe efektiv i cili ka rezultuar me ndikime relevante për parandalimin e krimet ekonomik dhe financiar dhe në dorëzimin e outputeve të Projektit tek institucionet relevante kombëtare duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e procesit.

Me ndihmën e ekipit të projektit, Qeveria e Kosovës ka themeluar mekanizmat e menaxhimittë rrezikut për ekonominë joformale, pastrimin e parasë, financimin e terrorizmit dhe krimetfinanciare. Dokumentet e rëndësishëm strategjik kanë qenë të miratuara në këtë periudhë:

- Vlerësimi i rrezikut kombëtar për pastrimin e parasë dhe financimin e terrorizmit i miratuar nga Qeveria e Kosovës më datën 18.12.2013;
- Strategjia kombëtare e Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014- 2018 e miratuar nga Qeveria e Kosovës më datën 28.1.2014;



- Plani i veprimit i Strategjisë kombëtare të Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018 i miratuar nga Qeveria e Kosovës me datën 28.1.2014;
- Buxhetet dhe planet e performancës së institucioneve relevante publike 2014-2018. Indikatorët relevant kyç të performancës të miratuar nga Qeveria e Kosovës me datën 28.1.2014;
- Partneriteti që siguron platformën ndërmjet institucioneve kombëtare të sektorit publik, privat dhe të tretë për sa i përket përpilimit, rishikimit, miratimit, implementimit dhe monitorimit të instrumenteve të menaxhimit të rrezikut. Strategjia kombëtare 2014-2018 e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 28.1.2014 përbëhet prej një instrumenti për rritjen e partneritetit ndërmjet këtyre tre sektorëve.

## **7.2. Projekti i BE&KiE “Kundër Krimin Ekonomik në Kosovë PECK”**

### **7.2.1. Cikli i dytë (II) i vlerësimit mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT)**

Në Maj të vitit 2015 është përmbyllur projekti i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Kundër Krimin Ekonomik në Kosovë PECK”. Projekti fillimisht ka filluar së implementuari në fillim të vitit 2012, me synimin kryesor për ta sjellë Kosovën më afër metodave të pranura ndërkombëtare të vlerësimit në këto fusha, përmes së cilit është përfunduar me sukses cikli i parë, për të vazhduar më pastaj me ciklin e dytë. Në kuadër të Projektit të bashkëfinancuar nga BE&KiE kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK), për herë të parë, Kosova u bë subjekt i një vlerësimi gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të kornizave të veta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (LPP/LFT), si dhe kundër korrupsionit (KK). Vlerësimi është bazuar në metodologjitë e zbatuara nga organet monitoruese evropiane për të gjitha Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Përgjatë periudhës implementuese të projektit 2012-2015 janë zhvilluar dy cikle të vlerësimit, që kanë përfshirë fushat institucionale, ligjore, politike dhe operative të ndara në tema të veçanta. Vlerësimi është modeluar kryesisht sipas MONEYVAL<sup>9</sup>. Këto metodologji janë përshtatur në mënyrë specifike për kontekstin e brendshëm në Kosovë. Këto vlerësime kanë rezultuar në gjetje dhe rekomandime konkrete, por edhe iu kanë siguruar institucioneve të Kosovës përvojë praktike mbi planifikimin, zbatimin dhe koordinimin e luftës kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave. Gjatë këtyre proceseve, institucionet e Kosovës kanë treguar përkushtim dhe gatishmëri serioze për të forcuar aftësitë e tyre, por nevojitet angazhim i mëtejshëm për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në raportet e vlerësimit.

Vlerësimi i sistemit të Kosovës në luftimin e pastrimit të parave dhe në luftimin e financimit të terrorizmit është bazuar në Rekomandimet e FATF-së të vitit 2003 dhe në Rekomandimet e veçanta mbi Financimin e Terrorizmit të vitit 2001 të Task Forcës së Veprimit Financiar – Financial Action Task Force (FATF) dhe është përgatitur duke përdorur metodologjinë e vlerësimit të LPP/LFT 2004 të përditësuara në shkurt të vitit 2009.

<sup>9</sup>Komisionit të Ekspertëve mbi Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit



Ekspertët e angazhuar nga Projekti PECK kanë shqyrtuar kornizën institucionale, të ligjeve, rregulloreve, udhëzuesve dhe të kërkesave të tjera të LPP/LFT-së, si dhe të rregullatorëve dhe sistemeve të tjera të krijuara për pengimin e Pastrimit të Parave (PP) dhe Financimit të Terrorizmit (FT) përmes institucioneve financiare, dhe Bizneseve dhe Profesioneve të Caktuara Jofinanciare (BPCJF-të) si dhe kanë kryer ekzaminimin e kapacitetit, zbatimit dhe efikasitetit të të gjitha këtyre sistemeve.

Kryesisht, struktura e këtij Raporti ka vijuar në masë të gjerë me strukturën e Raporteve të vlerësimeve të Raundit të Tretë të MONEYVAL-it dhe FATF-së. Publikimi i raportit përfundimtar është bërë në prill të vitit 2015 në Prishtinë në Konferencën përmbyllëse të Projektit për të prezantuar të gjeturat dhe rekomandimet e Raporteve Përfundimtare të Vlerësimit (cikli 2) mbi përputhshmërinë e Kosovës me standardet në fushat Kundër Korrupsionit (KK) dhe Kundër Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (KPP/LFT), si dhe rezultatet dhe mësimet e marra nga Projekti PECK. Përfaqësimi në këtë konferencë ishte i nivelit të lartë qeveritar dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare kompetente për fushat gjegjëse.



*Konferenca përmbyllëse e Projektit PECK 28 Prill 2015, Prishtinë*  
Burimi: Projekti PECK



Raporti i Vlerësimit është publikuar në të tri gjuhët (shqip, anglisht dhe serbisht) në faqen zyrtare të NjIF-K, përmes së cilit raport Lexuesi do të gjejë rezultatet e dy vlerësimeve. Te dy raportet ofrojnë analiza, gjetje dhe rekomandime të cilat ofrojnë baza të qëndrueshme për reforma të mëtejshme legislative, institucionale dhe operative në fushën e LPP/LFT në Kosovë. Me zbatimin e reformave, përputhshmëria me standardet përkatëse ndërkombëtare do të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme.

Në fund roli i NjIF-K si bartëse e komponentës së luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit si dhe angazhimi i liderit dhe roli i saj koordinues me të gjitha ministrat kompetente, institucionet qendrore, agjencitë ekzekutive, organet e zbatimit të ligjit, gjyqësorin, sektorin financiar dhe jo financiar dhe sektorin privat kanë qenë vendimtare për vlerësimet e suksesshme.



Raport Vlerësimi

#### Projekti kundër Krimin Ekonomik (PECK)

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



Implemented  
by the Council of Europe

Burimi: KiE-Projekti PECK



### **7.3. Mbështetja nga Thesari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

Mbështetja e NjIF-K nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë ka vazhduar edhe gjatë këtij viti kalendarik, duke dhënë kontribut të çmuar në ngritjen e kapaciteteve të njësisë në lidhje me luftën kundër shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Përveç këshillimeve dhe asistencës në lidhje legjislativonin dhe mbështetjes së aspektit operacional të NjIF-K, Ambasada Amerikane së bashku me ICITAP kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të NjIF-K përmes trajnimeve dhe punëtorive të organizuara gjatë vitit 2015 si në vijim:

- *Financimi i Terrorizmit, ICITAP, 11-15 Maj 2015, Prishtinë*
- *Financimi i Terrorizmit, ICITAP, 8-12 Qershor 2015, Zagreb, Kroaci*
- *DIILS Seminari Aspektet Ligjore të Luftimit të Korrupsionit, Ambasada Amerikane/Instituti i Mbrojtjes për Studime të Drejtës Ndërkombëtare, 14-17 Shtator 2015, Prishtinë*
- *Hetimet e avancuara të narkotikëve, Ambasada Amerikane/ICITAP, 22-25 Shtator 2015, Prishtinë.*

### **7.4. Mbështetja nga OSCE**

Gjatë vitit 2015, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka lansuar një projekt për rritjen e kapaciteteve të hetuesve për luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë. Projekti ka synuar që t'i lehtësojë dhe forcojë kapacitetet e "grupit kryesor" të hetuesve të institucioneve të zbatimit të ligjit me qëllim të hetimit efektiv dhe efikas të rasteve penale që ndërlidhen me nivelin e lartë të korrupsionit. Përveç institucioneve relevante dhe agjencive të ndryshme, pjesëmarrëse e vazhdueshme në aktivitetet e organizuara nga ky mision, ishte edhe NjIF-K, duke dhënë kontribut përmes pjesëmarrësve ose ligjëruesve.

Katër kurse trajnimi, dy seminare, një tryezë e rrumbullakët, dhe një konferencë rajonale të përbëra nga aktivitetet e këtij projekti, janë ndjekur me sukses nga zyrtarët e NjIF-K.

Gjatë këtij projekti, pjesëmarrësit kanë identifikuar që është arritur përparim në bashkëpunimin ndërinstytucional dhe shkëmbimin e informatave për hetime ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit. Në anën tjetër ata kanë identifikuar edhe zbrastërit dhe janë dakorduar për disa rekomandime për mënyrën se si të ecet përpara



## 8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017

Plani strategjik i NJIF-K i cili përshkruan detyrat, misionin, vizionin, qëllimet, objektivat dhe veprimet e Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NJIF-K) si dhe përmban parashikimin për alokim të resurseve dhe kontroll të brendshëm dhe për të cilat rezultatet e implementimit të planit të performancës dhe resurseve 2015-2017 janë rishikuar nga NjIF-K dhe pasi është bërë vlerësimi për përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të parapara në atë plan strategjikë ka rezultuar se ka pasur:

- fuqizim të masave parandaluese të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
- ngritje të vetëdijesimit dhe komunikimit për luftën kundër shpërlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- ngritje në vazhdimësi të bashkëpunimit me institucione të zbatimit të ligjit sa i përket zbulimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe konfiskimi i të ardhurave të krimit;
- është bërë draftimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- janë nxjerrë aktet nënligjore si dhe janë hartuar disa procedura standarde të veprimit të NjIF-K dhe është bërë sigurimi i implementimit efikas të tyre;
- janë nënshkruar marrëveshje të përbashkëta bashkëpunimi me institucionet tjera vendore,
- është krijuar qasja direkt në databazën e regjistrimit civil;
- është bërë ngritja e kapaciteteve të NjIF-K përmes trajnimeve dhe konferencave të ndjekura nga stafi i NjIF-K.
- është fuqizuar bashkëpunimi ndërkombëtar duke nënshkruar MM me FIU homologe ndërkombëtare,
- ka vazhduar përpjekja për anëtarësim në organizata ndërkombëtare

Plani i performancës dhe resurseve 2015-2017 përcakton se si NjIF-K do të zhvillojë kapacitetet e saj dhe të arriturat për t'i përmbushur dhe tejkaluar sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës tri vjeçare dhe se si do të ruajë pozitën e vet si një ndër njësitë efikase të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon. Ky plan gjithashtu tregon se si NjIF-K do të matë suksesin e vet dhe si do të kontrollojë proceset e veta të brendshme.

Kapitujt kryesor të përfshirë Planine Performancës dhe Resurseve janë paraqitur si në vijim:

1. Prezantim i detyrave, misionit, vizionit, qëllimeve strategjike dhe organizimit të njesisë si dhe objektivat, planet e veprimit dhe indikatorët e performancës;
2. Mjedisi Operativ i NjIF-K dhe Vlerësimi i Rrezikut;
3. Objektivat, zyrtarët përgjegjës, planet e veprimit dhe indikatorët e performancës;
4. Burimet Financiare, Njerëzore dhe të Teknologjisë Informativë dhe Plani i objektit dhe zyrave për NjIF-K.

Njëherit, Plani i Performancës dhe Resurseve 2015-2017 definojnë objektivat strategjike të NjIF-K. Ai gjithashtu përmban planet se si t'i arrijë ato dhe indikatorët kyç të performancës për të matur efikasitetin e njesisë. Janë përcaktuar 6 objektiva kryesore strategjike të NjIF-K për periudhën 2015-2017, të cilat janë paraqitur siç vijon:



1. Objektivi 1 – Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
2. Objektiva 2 – Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
3. Objektiva 3 – Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për detektimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimit të ardhurave nga krimi;
4. Objektiva 4 – Zhvillimi i legjislacionit kombëtar PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit të tyre efikas;
5. Objektiva 5 – Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
6. Objektiva 6 – Rritja e kapacitetit të NJIF-K.

Plani i Performancës dhe Resurseve 2015-2017 përmban gjithashtu burimet financiare (buxhetin e NJIF-K), burimet njerëzore, vlerësimin e performancës dhe zhvillimin e kapaciteteve të personelit të NJIF-K, teknologjinë informative dhe hapësirën punuese.

### **8.1. Objektivat e përcaktuara në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave dhe Programin e Qeverisë**


Në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave (PVPMF) për Vitin 2015 janë përcaktuar katër (4) objektiva strategjike të cilat kanë si synim parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Përbushja e këtyre objektivave është synuar të arrihet përmes shtatëmbëdhjetë (15) aktiviteteve në të cilat NJIF-K është institucion përgjegjës ose mbështetës. Objektivat e përcaktuara në Planin e Punës së MF janë në vijim:

- Kompletimi i kornizës ligjore për luftën kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit
- Forcimi i parandalimit si dhe luftës kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, promovimi i procedurave të inteligjencës
- Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- Ngritja e kapaciteteve të NJIF-it në luftimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit.

Ndërsa Programi Qevritar për vitin 2015 ka përcaktuar përbushjen e objektivit strategjik për NJIF-K dhe institucionet tjera relevante si në vijim:


- Luftimi i ekonomisë jo-formale dhe dukurisë së evazionit fiskal.
  - Hartimi i koncept dokumentit për ndryshimintëligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me standardet ndërkombëtare.
  - Ngritja e efektivitetit dhe efikasitetit në luftimin e ekonomisë jo formale.
  - Zhvillimi i operacioneve të përbashkëta me autoritete tjera të zbatimit të ligjit.

Sfidë për të ardhmen në përbushjen e planit të performancës mbetet:





- miratimi i ligjit të ndryshuar për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit
- ngritja edhe më tutje e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit
- promovimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit ndër-agjencor për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe me fokus të veçantë në konfiskimin e të ardhurave nga krimi,
- përmbushja e aktiviteteve që dalin nga zbatimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së,
- nxjerrja e akteve të reja nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit për PPP/PFT
- anëtarësimi i NjIF-K në Egmont Grup,
- sigurimi i hapësirave punuese të përshtatshme të NjIF-K e cila do të përmbushte kërkesat e sigurisë dhe hapësirës së nevojshme punuese,
- rritjen e kapaciteteve të NjIF-K me personel të ri dhe TI





Rr. Eduard Lir Nr.1 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org